

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E VUSHTRRIË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **644-26-3046-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Dezinfektimi, Dezinfektimi, Deratizimi (DDD) dhe largimi i zvarranikëve brejtësve**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Best D.D.D. SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Vellezerit Gervalla

(Adresa)

Ferizaj

70000

(Vendi)

(Kodi postar)

049851805

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Florian Syla



(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Floriansyla23@gmail.com

(Adresa elektronike)

19.06.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)


(Nënshkrimi dhe vula)


*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 Njoftim per Kontrat 06.05.2026 00:00

Kriteri për dhënien e kontratës

Procesverbali i hapjes -3046.pdf 03.06.2026 10:21

B47 KERKESE PER SQARIM TE DT.pdf 05.06.2026 11:36

LETËR SQARUESE PËR TENDERIN ME NR. TË PROKURIMIT 644-26-3046-2- 2-1.pdf 07.06.2026 17:11

B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK DDD dhe largimi i zvarranikëve brejtësve.pdf 08.06.2026 12:29

KËRKESË PËR QASJE NË DOKUMENTE.pdf 08.06.2026 12:59

[Vendimi i AK Lejimi i Qasjes 08.06.2026.pdf 08.06.2026 13:22](#)

[Kërkesë per rishqyrtim - Best D.D.D. SH.P.K. 11.06.2026 18:55](#)

[Konkluzion mbi pezullimin e perkoheshem.pdf 12.06.2026 08:29](#)

[VENDIMI REFUZUES I AK 12.06.2026_compressed.pdf12.06.2026 16:17](#)

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Hapja e ofertave është bërë përmes platformës së E-prokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 08.06.2026, kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë, me datë 11.06.2026.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë, me datë 12.06.2026, na ka njoftuar me Vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si të pabazuar, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Dezinsektimi, Dezinsektimi, Deratizimi (DDD) dhe largimi i zverranikëve brejtësve”, me Nr. të Prokurimit: 644-26-3046-2-2-1.

Bazuar në dispozitat e nenit 109 të LPP-së, parashtrojmë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit kundër Vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, si dhe kundër letrës standarde si GOE i eliminuar/i pasuksesshëm.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi
- Neni 7 i LPP-së – Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi
- Neni 28 i LPP-së – Specifikimet teknike
- Neni 51 i LPP-së – Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes
- Neni 56 i LPP-së – Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 60 i LPP-së – Kriteret për dhënien e kontratës
- Neni 64 i LPP-së – Dëshmitë dokumentare
- Neni 65 i LPP-së – Pranueshmëria e kandidatëve ose tenderuesve
- Neni 67 i LPP-së – Provat shkresore
- Neni 69 i LPP-së – Kapaciteti teknik dhe profesional
- Neni 70 i LPP-së – Standardet për sigurimin e cilësisë
- Neni 71.4 i LPP-së – Grupet e Operatorëve Ekonomik
- Neni 72 i LPP-së – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- Neni 19 i Rregullores Nr. 001/2022 – Specifikimet teknike
- Neni 26.5 i Rregullores Nr. 001/2022 – Kërkesat ndaj Grupit të Operatorëve Ekonomik si tërësi
- Neni 26.9 i Rregullores Nr. 001/2022 – Autorizimi/licenca të Grupet e Operatorëve Ekonomik
- Neni 38.6 i Rregullores Nr. 001/2022 – Sqarimi i tenderëve / afati për sqarim

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Konsiderojmë se eliminimi i GOE-së tonë është bërë mbi bazë të interpretimeve të zgjeruara, formale dhe selektive të kërkesave të Dosjes së Tenderit, ndërsa dokumentacioni i OE-së së rekomanduar është pranuar pavarësisht mospërputhjeve, mangësive dhe dëshmive të pamjaftueshme të evidentuara gjatë qasjes në dokumente.

Për secilin pretendim do të paraqesim kërkesën konkrete të DT/NJK, dokumentin

përkatës, shkeljen e konstatuar dhe arsyen pse vlerësimi i AK-së është i gabuar, i padrejtë dhe në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës së ndershme dhe përdorimit efikas të parasë publike.

Pretendimi Nr.1 :

Autoriteti Kontraktues ka eliminuar ofertën tonë duke interpretuar gabimisht kërkesën për ISO 9001:2015 dhe lejen për importimin e produkteve biocide

Ne, Grupi i Operatorëve Ekonomik Best D.D.D. SH.P.K.; Shaqir Brahimi B.I.; Vlera SH.P.K., e kontestojmë në tërësi arsyetimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me eliminimin e ofertës sonë mbi bazën e pretendimit se secili anëtar i GOE-së është dashur të posedojë veçmas ISO 9001:2015 dhe leje për importimin e produkteve biocide.

Në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, te “Arsyetimi nr. 1”, AK ka theksuar se në DT/NJK është kërkuar që OE të jetë i certifikuar me ISO 9001:2015 për shërbime cilësore të DDD-së dhe të ofrojë dëshmi se posedon leje për importimin e produkteve biocide. Më pas, AK ka konstatuar se lideri i grupit, Best D.D.D. SH.P.K., i posedon këto dëshmi, ndërsa anëtarët tjerë të GOE-së, përkatësisht Shaqir Brahimi B.I. / N.SH. Preventiva dhe Vlera SH.P.K., nuk i posedojnë veçmas këto dokumente.

Ky arsyetim është i gabuar, sepse AK ka marrë një kërkesë të formuluar në nivel të Operatorit Ekonomik / Grupit të Operatorëve Ekonomik dhe e ka shndërruar gjatë fazës së vlerësimit në kërkesë individuale për secilin anëtar të GOE-së, pa pasur një bazë të tillë të qartë në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë.

Kërkesa e DT-së, siç e citon edhe vetë AK në vendim, ka qenë: “OE duhet të jetë i certifikuar me ISO standard 9001:2015...” dhe “Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se posedon leje për importimin e produkteve biocide...”. Pra, kërkesa është vendosur ndaj OE-së si ofertues. Në rastin tonë ofertuesi është Grupi i Operatorëve Ekonomik, dhe jo secili anëtar i grupit i trajtuar si ofertues i ndarë.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur qëllim që secili anëtar i GOE-së të posedojë veçmas ISO 9001:2015 dhe leje për import të produkteve biocide, një kërkesë e tillë është dashur të përcaktohej qartë, shprehimisht dhe pa dykuptimësi në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Një kusht i tillë nuk mund të krijohet pas hapjes së ofertave dhe gjatë fazës së vlerësimit.

Në arsyetimin e eliminimit, AK është thirrur në nenin 66 dhe nenin 70 të LPP-së, si dhe në nenin 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik. Mirëpo, AK ka bërë interpretim të gabuar dhe selektiv të këtyre dispozitave, duke anashkaluar dispozitat që rregullojnë drejtpërdrejt ofertimin nga grupet e operatorëve ekonomik.

Sipas nenit 71.4 të LPP-së, kur tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, kërkesat e vendosura nga AK sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të LPP-së aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

Ky rregull përsëritet dhe sqarohet edhe në nenin 26.5 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, ku përcaktohet se kërkesat sipas nenit 66.2 të LPP-së, nenit 68 dhe nenit 69 aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

Për më tepër, për çështjen e lejes/autorizimit, e cila lidhet drejtpërdrejt me nenin 66.2 të LPP-së, neni 26.9 i Rregullores Nr. 001/2022 përcakton qartë se kur lënda e aktivitetit përfshin shërbime profesionale që mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik i

autorizuar ose licencuar, mjafton që njëri anëtar i grupit të ketë autorizimin/licencën përkatëse dhe ta dorëzojë dëshminë, në mënyrë që të konsiderohet se grupi e ka përmbushur këtë kërkesë si tërësi.

Në rastin konkret, lideri i grupit, Best D.D.D. SH.P.K., e ka dorëzuar lejen për importimin e produkteve biocide. Për rrjedhojë, kërkesa për leje/autorizim është përmbushur në nivel të GOE-së si tërësi. AK nuk ka pasur bazë ligjore që të kërkojë të njëjtën leje edhe nga secili anëtar tjetër i grupit, kur një gjë e tillë nuk është kërkuar shprehimisht në DT/NJK dhe kur rregullat e prokurimit publik lejojnë përmbushjen e kësaj kërkesë nga njëri anëtar i grupit. Sa i përket ISO 9001:2015, AK është thirrur në nenin 70 të LPP-së dhe nenin 26.6 të Rregullores Nr. 001/2022. Mirëpo këto dispozita rregullojnë mundësinë e kërimit të certifikatave për sigurimin e cilësisë, por nuk përcaktojnë se në rast të një GOE-je secili anëtar individualisht duhet të posedojë certifikatë ISO 9001:2015, përveç nëse kjo është kërkuar qartë në dokumentet e tenderit.

Në këtë aktivitet të prokurimit, AK nuk ka përcaktuar në mënyrë të qartë në DT/NJK se secili anëtar i grupit duhet të jetë i certifikuar veçmas me ISO 9001:2015. Prandaj, ISO 9001:2015 e dorëzuar nga lideri i grupit, Best D.D.D. SH.P.K., duhet të konsiderohet e mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës në nivel të GOE-së, sidomos duke marrë parasysh se lideri i grupit është operatori që posedon kapacitetin përkatës dhe do të jetë përgjegjës për realizimin dhe menaxhimin e shërbimeve përkatëse.

Arsyetimi i AK-së se, për shkak të marrëveshjes së themelimit të GOE-së dhe përqindjes së pjesëmarrjes së anëtarëve në grup, secili anëtar duhet të posedojë ISO dhe leje importi, është i pabazuar. Përqindja e pjesëmarrjes në GOE nuk krijon detyrim ligjor që secili anëtar të posedojë të gjitha licencat, autorizimet dhe certifikatat e kërkuara, kur ligji dhe rregullorja përcaktojnë se kërkesat përkatëse vlerësohen ndaj grupit si tërësi.

Marrëveshja e GOE-së përcakton përgjegjësinë e përbashkët të anëtarëve për realizimin e kontratës, por nuk mund të përdoret nga AK për të krijuar kritere shtesë që nuk janë përcaktuar në DT/NJK. Nëse AK ka dashur që secili anëtar, pavarësisht rolit të tij në GOE, të posedojë veçmas ISO dhe leje importi, ky kusht është dashur të jetë i paraparë qartë në dokumentet e tenderit, e jo të nxirret si interpretim pas dorëzimit të ofertave.

Në letrën tonë sqaruese të datës 07.06.2026, ne kemi sqaruar qartë se në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë nuk është kërkuar që secili anëtar individual i GOE-së të posedojë veçmas ISO 9001:2015 dhe leje për import të produkteve biocide. Po ashtu kemi sqaruar se kërkesa është përmbushur në nivel të GOE-së përmes liderit Best D.D.D. SH.P.K. Përkundër kësaj, AK nuk e ka trajtuar në mënyrë përmbajtësore sqarimin tonë, por ka vazhduar me të njëjtin interpretim të gabuar, duke e eliminuar ofertën tonë mbi bazën e një kërkesë që nuk është përcaktuar qartë në dokumentet e tenderit dhe që bie ndesh me rregullat për vlerësimin e GOE-së.

Ky veprim i AK-së përbën aplikim të një kriteri shtesë gjatë fazës së vlerësimit dhe është në kundërshtim me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Po ashtu, një eliminim i tillë është në kundërshtim me parimin se ofertuesi nuk mund të diskualifikohet mbi bazën e një kërkesë apo kriteri që nuk është i përcaktuar qartë në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës sonë nuk qëndron as në aspektin faktik dhe as në aspektin ligjor, por paraqet interpretim të zgjeruar, selektiv dhe të pabazuar të kërkesave të Dosjes së Tenderit, me efekt të drejtpërdrejtë në favorizimin e Operatorit

Ekonomik të rekomanduar për kontratë. Në rastin konkret, GOE ynë ka ofertuar çmimin prej 47,772.00 €, ndërsa Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofertuar çmimin prej 51,464.00 €, pra 3,692.00 € më shtrenjtë se oferta jonë. Përkundër kësaj, AK ka eliminuar ofertën tonë duke aplikuar kritere të paqarta dhe interpretime që nuk burojnë drejtpërdrejt nga DT/NJK, duke e larguar nga konkurrenca ofertën ekonomikisht më të favorshme dhe duke krijuar përfitim të padrejtë procedural për OE-në e rekomanduar. Një vlerësim i tillë cenon rëndë parimet themelore të prokurimit publik, përfshirë transparencën, trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, konkurrencën e ndershme dhe përdorimin efikas të parasë publike, pasi rezultati i këtij interpretimi të gabuar është rekomandimi për kontratë i një operatori ekonomik me ofertë dukshëm më të shtrenjtë se oferta jonë.

Për më tepër, AK në vendimin e eliminimit është thirrur në nenet 51, 52 dhe 60 të LPP-së, si dhe në nenin 4 paragrafi 1.26 të LPP-së, duke theksuar se OE ankues nuk mund të dëshmojë interes material. Ky arsytim është po ashtu i gabuar, sepse GOE ynë ka dorëzuar ofertë në këtë aktivitet të prokurimit dhe është eliminuar me vendim të AK-së, ndërsa oferta jonë ka qenë me çmim më të ulët se oferta e OE-së së rekomanduar për kontratë. Prandaj, interesi ynë material dhe procedural është i drejtpërdrejtë, real dhe i pakontestueshëm.

Në këtë rast, eliminimi i ofertës sonë ka ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin e aktivitetit të prokurimit, pasi nëse oferta jonë do të vlerësohej në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me LPP-në, Rregulloren dhe DT/NJK, do të duhej të mbetej në vlerësim si ofertë me çmim më të ulët se oferta e operatorit të rekomanduar.

Prandaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta aprovojë këtë pretendim si të bazuar, ta anulojë arsyen e eliminimit lidhur me ISO 9001:2015 dhe lejen për import të produkteve biocide, dhe të konstatojë se GOE ynë e ka përmbushur këtë kërkesë në nivel grupi përmes liderit Best D.D.D. SH.P.K.

Rrjedhimisht, kërkojmë që oferta jonë të rikthehet në rivlerësim dhe të vlerësohet në përputhje me dispozitat e LPP-së, Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, pa aplikim të kritereve shtesë dhe pa interpretim të zgjeruar të kërkesave të tenderit.

Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së AK në Pretendimin nr. 1

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues në Pretendimin nr. 1 është e pasakt, e paqëndrueshme dhe në kundërshtim me vetë kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë. AK përpiqet ta arsyetojë eliminimin tonë duke pretenduar se kërkesat për ISO 9001:2015 dhe leje për importimin e produkteve biocide duhet të plotësohen veçmas nga secili anëtar i GOE-së. Mirëpo, një kërkesë e tillë nuk ka qenë e përcaktuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit dhe as në Njoftimin për Kontratë. Nëse AK ka dashur që secili anëtar i grupit të posedojë veçmas ISO 9001:2015 dhe leje për importimin e produkteve biocide, këtë ka qenë i obliguar ta përcaktojë qartë para dorëzimit të ofertave, e jo ta krijojë si kusht të ri gjatë fazës së vlerësimit.

Thirrja e AK-së në nenin 59.4 të LPP-së nuk e arsyeton eliminimin tonë, sepse ky nen ka të bëjë me vlerësimin e tenderit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dosje dhe njoftim, por nuk i jep të drejtë AK-së të shtojë kritere të reja pas hapjes së ofertave. Përkundrazi, vlerësimi duhet të bëhet vetëm mbi bazën e kushteve të publikuara paraprakisht.

Gjithashtu, pretendimi i AK-së se GOE është dashur të kërkojë sqarim para hapjes së tenderit është i paqëndrueshëm. GOE nuk ka pasur arsye të kërkojë sqarim për një kusht që nuk ka qenë i paqartë dhe nuk ka qenë i përcaktuar si kërkesë individuale për secilin anëtar. Paqartësia është krijuar nga vetë AK gjatë fazës së vlerësimit, kur kërkesën e vendosur në nivel të OE/GOE-së e ka interpretuar si kërkesë individuale për secilin anëtar të grupit.

Për më tepër, krahasimi që AK bën me certifikatën e biznesit dhe TVSH-në nuk është i qëndrueshëm, sepse këto janë dokumente administrative që lidhen me subjektivitetin juridik të secilit anëtar, ndërsa ISO 9001:2015 dhe leja për importimin e produkteve biocide janë kërkesa profesionale/teknike që, në mungesë të një kërkesë të qartë ndryshe, duhet të vlerësohen në nivel të Grupit të Operatorëve Ekonomik si tërësi.

Në rastin konkret, lideri i GOE-së, Best D.D.D. SH.P.K., i ka dorëzuar dëshmitë për ISO 9001:2015 dhe lejen për importimin e produkteve biocide. Duke qenë se dokumentet e tenderit nuk kanë kërkuar shprehimisht që këto dëshmi të posedohen individualisht nga secili anëtar i GOE-së, përmbushja e tyre nga lideri i grupit duhet të konsiderohet e mjaftueshme për GOE-në si tërësi.

Përfundimisht, arsyetimi i AK-së se GOE është i papërgjegjshëm dhe pa interes është i pabazuar. GOE ynë ka interes të drejtpërdrejtë dhe të ligjshëm në këtë procedurë, sepse ka dorëzuar ofertë të rregullt, është eliminuar me interpretim të zgjeruar të kriterëve dhe ka ofertuar çmim më të ulët se OE i rekomanduar për kontratë.

Andaj, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë se arsyetimi i AK-së për Pretendimin nr. 1 është i pasaktë dhe i paqëndrueshëm, pasi bazohet në interpretim të zgjeruar të kriterëve të tenderit dhe në kërkesë të papublikuar paraprakisht. Duke qenë se GOE ynë ka plotësuar në tërësi kërkesat e publikuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë lidhur me ISO 9001:2015 dhe lejen për importimin e produkteve biocide, kërkojmë që ky pretendim të aprovohet si i bazuar dhe të konstatohet se GOE ynë i ka përmbushur plotësisht kërkesat e përshtatshëmrisë profesionale të përcaktuara nga AK.

Pretendimi Nr.2

Autoriteti Kontraktues ka eliminuar ofertën tonë mbi bazën e një interpretimi formal, selektiv dhe të padrejtë të dëshmimeve për kapacitetin teknik/profesional – Stafi

Ne, Grupi i Operatorëve Ekonomik Best D.D.D. SH.P.K.; Shaqir Brahimi B.I.; Vlera SH.P.K., kontestojmë në tërësi arsyetimin e dytë të Autoritetit Kontraktues lidhur me eliminimin e ofertës sonë, përkatësisht pretendimin se nuk është përmbushur kërkesa për kapacitetin teknik/profesional lidhur me Menaxherin e Kontratës dhe stafin teknik të trajnuar/certifikuar për shërbime DDD.

Ky arsyetim i AK-së është i pabazuar, formalist, selektiv dhe nuk e trajton dokumentacionin e dorëzuar sipas përmbajtjes reale të tij, por vetëm sipas një interpretimi të ngushtë dhe të pafavorshëm ndaj GOE-së tonë. Në këtë mënyrë, AK ka shpërfillur dëshmitë zyrtare të dorëzuara nga ne dhe ka krijuar bazë artificiale për eliminimin e ofertës sonë.

Sa i përket Menaxherit të Kontratës, z. Shaqir Brahimi, AK ka konstatuar se është dorëzuar Certifikatë nga Ministria e Shëndetësisë – UNMIK, datë 16.07.2003, por jo edhe Diploma universitare. Ky konstatim është i padrejtë dhe jo përmbajtësor, sepse dokumentet e

dorëzuar nuk janë dëshmi të zakonshme apo të paqarta, por janë dokumente zyrtare të institucioneve kompetente shëndetësore dhe profesionale, të cilat dëshmojnë qartë se z. Shaqir Brahimi është Doktor i Mjekësisë dhe Specialist i Epidemiologjisë.

Certifikata e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë / UNMIK e identifikon z. Shaqir Brahimi me titullin “Doktor i Mjekësisë” dhe vërteton se i njëjti ka kryer provimin specialistik dhe ka fituar titullin e mjekut specialist nga lëmia e Epidemiologjisë. Pra, ky dokument dëshmon drejtpërdrejt kualifikimin profesional bazë dhe specialistik të personit të propozuar si Menaxher i Kontratës.

Për më tepër, është dorëzuar edhe Licenca e Punës e lëshuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës, e cila e licencën z. Shaqir Brahimi si Specialist i Epidemiologjisë për ushtrimin e profesionit në Republikën e Kosovës. Një licencë e tillë nuk mund të lëshohet pa verifikimin paraprak të kualifikimit arsimor dhe profesional nga organi kompetent. Prandaj, AK nuk ka pasur bazë të injorjës këto dëshmi zyrtare dhe të pretendojë se nuk është dëshmuar kualifikimi profesional vetëm sepse dokumenti nuk mban formalisht titullin “Diplomë”.

Këtë e vërteton edhe vetë Oda e Mjekëve të Kosovës në faqen zyrtare për licencim, ku përcaktohet se licencimi/rilicencimi i mjekëve është i detyrueshëm për të gjithë mjekët që duan ta ushtrojnë veprimtarinë mjekësore sipas autorizimeve ligjore, ndërsa licenca e punës është dokument publik që vërteton përmbushjen e kushteve nga ana e mjekut. Për më tepër, në Rregulloren për Anëtarësim, Licencim dhe Rilicencim në OMK përcaktohen procedurat dhe kushtet për licencimin e doktorëve të mjekësisë, specialistëve dhe subspecialistëve.

Prandaj, fakti që Dr. Shaqir Brahimi është licencuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës si Specialist i Epidemiologjisë dëshmon se organi kompetent profesional e ka verifikuar dhe pranuar kualifikimin e tij profesional. AK nuk mund ta shpërfillë këtë licencë dhe ta trajtojë si të padëshmuar kualifikimin bazë profesional, kur vetë institucioni kompetent për licencimin e mjekëve në Republikën e Kosovës e ka njohur dhe licencuar atë si Specialist të Epidemiologjisë.

Si dëshmi shtesë lidhur me vlerën juridike dhe profesionale të Licencës së Punës të lëshuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës, i referohemi edhe faqes zyrtare të OMK-së për licencim: <https://omk-rks.org/licencmi/>

Në këtë faqe zyrtare përcaktohet qartë se: “Licenca e punës është dokument publik i cili vërteton përmbushjen e kushteve nga ana e mjekut.” Ky formulim dëshmon se licenca e punës nuk është dokument formal pa vlerë dëshmuuese, por dokument publik i lëshuar nga organi kompetent profesional, i cili vërteton se mjeku i licencuar i ka përmbushur kushtet e nevojshme për ushtrimin e profesionit.

Po ashtu, bashkëngjitur kësaj kërkesë po dorëzojmë edhe Rregulloren zyrtare të Odës së Mjekëve të Kosovës për Anëtarësim, Licencim dhe Rilicencim në OMK, e cila gjendet në linkun zyrtar: <https://omk-rks.org/wp-content/uploads/KO-08-2025-Rregullorja-per-Anetaresim-Licencim-dhe-Rilicencim-ne-OMK.pdf>

Kjo rregullore përcakton procedurat dhe kushtet për anëtarësim, licencim dhe rilicencim të doktorëve të mjekësisë, specialistëve dhe subspecialistëve. Prandaj, fakti që Dr. Shaqir Brahimi është licencuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës si Specialist i Epidemiologjisë dëshmon se organi kompetent profesional e ka verifikuar dhe pranuar kualifikimin e tij profesional. Për këtë arsye, AK nuk mund ta shpërfillë licencën e punës dhe dokumentet

zyrtare të lëshuara nga institucionet kompetente, duke pretenduar se nuk është dëshmuar kualifikimi profesional bazë.

Qëllimi i kërkesës për diplomë në Dosjen e Tenderit nuk është formalizmi i emërimit të dokumentit, por verifikimi i faktit nëse personi i propozuar është Veterinar, Mjek Veterinar ose Epidemiolog me përvojë dhe certifikim për DDD. Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton qartë dhe pa asnjë dyshim se z. Shaqir Brahimi është Epidemiolog, Specialist i Epidemiologjisë, i licencuar për ushtrimin e profesionit dhe me përvojë profesionale shumë më të gjatë se 5 vite.

Autoriteti Kontraktues, në vend që të vlerësojë përmbajtjen reale të dokumenteve, ka zgjedhur ta trajtojë mungesën e një dokumenti me emërtim formal “Diplomë” si arsye eliminimi, pavarësisht se dokumentet e dorëzuara e dëshmojnë qartë të njëjtin fakt për të cilin është kërkuar diploma. Ky është vlerësim i ngushtë, jo objektiv dhe në kundërshtim me parimin e vlerësimit përmbajtësor të ofertave.

Sa i përket stafit teknik, AK ka konstatuar se certifikatat e dorëzuara dëshmojnë vetëm “marrje pjesë në trajnim”, por nuk dëshmojnë “kryerjen me sukses të trajnimit/kursit për shërbime DDD”. Ky arsyetim është po ashtu i pabazuar dhe paraqet interpretim të shkëputur të një shprehjeje të vetme në certifikatë, duke anashkaluar titullin, përmbajtjen, programin, kohëzgjatjen dhe validitetin e certifikatave të dorëzuara.

Kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë që së paku 2 punëtorë të jenë të trajnuar/certifikuar për kryerjen e shërbimeve DDD dhe të dorëzohen kopje të certifikatave për kryerjen e trajnimit për shërbimin DDD, së bashku me kontratat e punës. Ne kemi dorëzuar pikërisht këtë: kontratat e punës dhe certifikatat e trajnimit për z. Besart Ismajli dhe z. Florian Syla.

Certifikatat e dorëzuara mbajnë qartë titullin “Kurs Trajnimi për kryerjen e Shërbimeve DDD”. Ky formulim nuk i referohet një ligjërate të përgjithshme apo një pranie formale, por një kursi trajnimi për kryerjen e shërbimeve DDD. Për më tepër, certifikatat përmbajnë module teorike dhe praktike, kohëzgjatje prej 32 orësh, datë trajnimi, datë lëshimi dhe datë skadence. Këto elemente e bëjnë të qartë se kemi të bëjmë me certifikata profesionale trajnimi, jo me vërtetime të thjeshta prezence.

AK nuk mund të shkëpusë vetëm shprehjen “mori pjesë në trajnim” dhe ta përdorë atë për ta zhvlerësuar të gjithë certifikatën, ndërsa të anashkalojë faktin se certifikata është lëshuar për “Kurs Trajnimi për kryerjen e Shërbimeve DDD” dhe përmban program të plotë profesional teorik dhe praktik. Ky është vlerësim selektiv dhe i padrejtë i dokumentacionit.

Nëse AK kishte paqartësi nëse certifikata dëshmon trajnim/certifikim të stafit, ishte e detyruar ta vlerësonte certifikatën në tërësi ose të kërkonte verifikim/sqarim nga lëshuesi i certifikatës. AK nuk mund të marrë rolin e organit certifikues dhe, në mënyrë arbitrare, ta shpallë një certifikatë të pavlefshme vetëm sepse nuk përmban fjalinë e saktë që AK dëshiron ta lexojë, kur vetë përmbajtja e certifikatës e dëshmon trajnimin për kryerjen e shërbimeve DDD.

Për më tepër, në vendimin e eliminimit, AK e krahason dokumentacionin tonë me dokumentacionin e OE-së së rekomanduar për kontratë, duke theksuar se OE i rekomanduar ka paraqitur certifikatë ku thuhet “ka kryer me sukses këtë kurs/trajnim”. Ky krahasim dëshmon qartë se AK ka aplikuar standard të dyfishtë dhe ka përdorur dallime formale në formulimin e certifikatave për të eliminuar ofertën tonë, pa u bazuar në kërkesën reale të DT/NJK.

Në Dosjen e Tenderit nuk është përcaktuar se certifikata duhet domosdoshmërisht të përmbajë fjalët “ka kryer me sukses”, as nuk është kërkuar dëshmi për provim, testim apo vlerësim final të stafit teknik. Kërkesa ka qenë që punëtorët të jenë të trajnuar/certifikuar për shërbime DDD. Certifikatat tona e dëshmojnë këtë kërkesë në përmbajtje. Prandaj, AK nuk ka pasur bazë ligjore të shtojë një kusht të ri gjatë vlerësimit, duke kërkuar formulim të veçantë që nuk ka qenë pjesë e DT/NJK.

Ky veprim i AK-së përbën interpretim të zgjeruar dhe të padrejtë të kërkesës së tenderit, duke e kthyer një dallim formal në arsye eliminimi. Në vend që të vlerësojë nëse stafi teknik është i trajnuar/certifikuar për DDD, AK është fokusuar në një formulim të vetëm dhe ka anashkaluar të gjithë përmbajtjen profesionale të certifikatave.

Në këtë mënyrë, AK ka dëmtuar drejtpërdrejt GOE-në tonë dhe ka krijuar efekt të qartë favorizues për OE-në e rekomanduar për kontratë. Oferta jonë ka qenë më e lirë, ndërsa AK e ka eliminuar duke përdorur arsye formale dhe të pabazuara, duke rekomanduar për kontratë një OE me ofertë më të shtrenjtë. Ky rezultat cenon konkurrencën e ndershme, trajtimin e barabartë, transparencën dhe përdorimin efikas të parasë publike.

Arsyetimi i AK-së se certifikatat tona “nuk dëshmojnë kryerjen e trajnimit” nuk qëndron, sepse certifikatat dëshmojnë qartë trajnimin për kryerjen e shërbimeve DDD, përmbajnë module praktike dhe teorike, janë të lëshuara nga organi përkatës dhe kanë validitet. AK nuk ka ofruar asnjë bazë objektive për ta shpallur të pamjaftueshme këtë dokumentacion, përveç një interpretimi formal dhe të njëanshëm.

Në sqarimet tona të dorëzuara pranë Autoritetit Kontraktues, ne kemi sqaruar në mënyrë të detajuar se dokumentet për z. Shaqir Brahimi dhe certifikatat për stafin teknik dëshmojnë përmbushjen e plotë të kërkesave të DT/NJK. Megjithatë, AK nuk i ka trajtuar këto sqarime në mënyrë objektive dhe përmbajtësore, por i ka anashkaluar ato dhe ka vendosur eliminimin e ofertës sonë mbi bazën e interpretimeve formale dhe selektive.

Për këto arsye, kërkojmë që ky pretendim të aprovohet si i bazuar, të anulohet arsyetimi i AK-së lidhur me kapacitetin teknik/profesional – Stafi, dhe të konstatohet se GOE ynë ka përmbushur kërkesat e DT/NJK për Menaxherin e Kontratës dhe për 2 punëtorët e trajnuar/certifikuar për kryerjen e shërbimeve DDD.

Rrjedhimisht, kërkojmë që oferta jonë të rikthehet në rivlerësim dhe të vlerësohet në mënyrë objektive, të barabartë dhe në përputhje me përmbajtjen reale të dokumenteve të dorëzuara, pa aplikim të kriterëve shtesë, pa formalizëm të tepruar dhe pa standarde të dyfishta në raport me OE-në e rekomanduar për kontratë.

Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së AK-së në Pretendimin nr. 2

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues në lidhje me Pretendimin nr. 2 është e pasaktë, e paqëndrueshme dhe nuk e trajton në mënyrë përmbajtësore dokumentacionin e dorëzuar nga GOE ynë.

AK, në përgjigjen e saj, përsërit të njëjtin arsyetim formal se për Menaxherin e Kontratës nuk është dorëzuar dokument me emërtimin “Diplomë”, duke anashkaluar faktin se dokumentet e dorëzuara dëshmojnë qartë kualifikimin profesional të z. Shaqir Brahimi si Doktor i Mjekësisë dhe Specialist i Epidemiologjisë. Certifikata e Ministrisë së

Shëndetësisë / UNMIK dhe Licenca e Punës e Odës së Mjekëve të Kosovës janë dokumente zyrtare të institucioneve kompetente, të cilat dëshmojnë përmbushjen e kushtit profesional të kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Qëllimi i kërkesës në Dosjen e Tenderit nuk ka qenë vetëm posedimi formal i një dokumenti me titull “Diplomë”, por verifikimi se personi i propozuar është Veterinar, Mjek Veterinar ose Epidemiolog, me përvojë dhe certifikim për DDD. Ky fakt është dëshmuar nga GOE ynë përmes dokumenteve zyrtare të dorëzuara. Për këtë arsye, AK ka gabuar kur ka vlerësuar vetëm emërtimin formal të dokumentit dhe jo përmbajtjen reale të tij.

Po ashtu, sa i përket certifikatave të stafit teknik, AK gabimisht e kufizon vlerësimin vetëm në shprehjen “marrje pjesë në trajnim”, duke anashkaluar titullin dhe përmbajtjen e certifikatave. Certifikatat e dorëzuara mbajnë titullin “Kurs Trajnimi për kryerjen e Shërbimeve DDD”, përmbajnë module teorike dhe praktike, kohëzgjatje prej 32 orësh, datë lëshimi dhe vlefshmëri. Këto elemente dëshmojnë qartë se certifikatat lidhen me trajnimin për kryerjen e shërbimeve DDD dhe jo me një prezencë të thjeshtë formale. AK në mënyrë të pasaktë pretendon se kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë vetëm për “certifikatë për kryerjen e trajnimit” dhe jo për “certifikatë për marrje pjesë në trajnim”, mirëpo në Dosjen e Tenderit nuk është përcaktuar se certifikata duhet të përmbajë domosdoshmërisht formulimin “ka kryer me sukses”, as nuk është kërkuar dëshmi për provim, testim apo vlerësim final. Prandaj, AK nuk ka pasur të drejtë të shtojë një kusht të ri gjatë fazës së vlerësimit.

Thirrja e AK-së në nenin 59.4 të LPP-së nuk e arsyeton eliminimin tonë, sepse ky nen kërkon vlerësim në përputhje me kërkesat e publikuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, e jo aplikim të interpretimeve shtesë apo të formulimeve që nuk kanë qenë të përcaktuara paraprakisht.

Gjithashtu, pretendimi i AK-së se GOE është dashur të kërkojë sqarim para hapjes së tenderit është i paqëndrueshëm, sepse kërkesa nuk ka qenë e paqartë për GOE-në. GOE ynë ka dorëzuar dokumentet që në përmbajtje dëshmojnë përmbushjen e kërkesës. Paqartësia është krijuar nga vetë AK gjatë fazës së vlerësimit, përmes një interpretimi të ngushtë dhe formal të dokumenteve të dorëzuara.

Nëse AK ka pasur dyshim lidhur me përmbajtjen e certifikatave apo kualifikimin profesional të Menaxherit të Kontratës, ka pasur mundësi dhe detyrim që këtë ta trajtojë përmes sqarimit/verifikimit të dokumenteve, e jo ta përdorë menjëherë si arsye për eliminim. AK nuk mund ta shpallë një dokument të pamjaftueshëm vetëm për shkak të formulimit formal, kur përmbajtja e tij dëshmon qartë përmbushjen e kërkesës.

Për këto arsye, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë se arsyetimi i AK-së për Pretendimin nr. 2 është i pasaktë, formal dhe i paqëndrueshëm, pasi nuk mbështetet në vlerësimin përmbajtësor të dokumenteve të dorëzuara. Duke qenë se GOE ynë ka dëshmuar në tërësi përmbushjen e kërkesave të publikuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë lidhur me Menaxherin e Kontratës dhe stafin teknik të trajnuar/certifikuar për shërbime DDD, kërkojmë që ky pretendim të aprovohet si i bazuar dhe të konstatohet se GOE ynë ka përmbushur plotësisht kërkesat e kapacitetit teknik/profesional – Stafi.

Pretendimi Nr.3:

Pretendimi Nr.3.1:

Ne, Grupi i Operatorëve Ekonomik Best D.D.D. SH.P.K.; Shaqir Brahimi B.I.; Vlera SH.P.K., kontestojmë në tërësi vlerësimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me pranimin si të përgjegjshme të ofertës së Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë, S.V. “Veterina”, për sa i përket kërkesës për kontrata të ngjashme të realizuara.

Sipas Dosjes së Tenderit, Operatori Ekonomik është dashur të dëshmojë kontrata të ngjashme të realizuara në periudhën e kërkuar 3-vjeçare nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, në vlerë së paku 40,000.00 €, dhe këto kontrata duhet të jenë të natyrës së ngjashme me shërbimet e kërkuara, përkatësisht shërbime të Dezinfektimit, Dezinfektimit dhe Deratizimit.

Nga dokumentacioni i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, të cilin e kemi siguruar pas kërkesës për qasje në dokumente, rezulton qartë se lista e kontratave e dorëzuar nga S.V. “Veterina” është e mbushur me kontrata dhe referenca që nuk i plotësojnë kërkesat e DT/NJK, për shkak se janë jashtë periudhës 3-vjeçare, nuk janë të natyrës së ngjashme me shërbimet DDD, kanë mospërputhje serioze ndërmjet listës së kontratave dhe referencave të dorëzuara, ose janë të palexueshme dhe të pamundshme për t’u verifikuar në mënyrë objektive.

Pavarësisht këtyre mangësive të dukshme, Autoriteti Kontraktues, Drejtori i Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit e kanë trajtuar ofertën e OE-së së rekomanduar si të përgjegjshme, duke pranuar pa verifikim real një listë kontratash që nuk përputhet me kërkesat e tenderit. Ky është një dështim serioz i vlerësimit dhe tregon qartë se ndaj OE-së së rekomanduar është aplikuar standard më i butë, ndërsa ndaj GOE-së tonë është aplikuar standard tepër i ashpër dhe eliminues.

OE i rekomanduar ka deklaruar në listën e kontratave vlerën totale prej 85,344.19 €. Mirëpo, pas analizimit të dokumenteve dhe referencave të dorëzuara, rezulton se shumica dërrmuese e këtyre kontratave nuk mund të pranohen si dëshmi valide për përmbushjen e kërkesës prej 40,000.00 €, sepse nuk plotësojnë kushtin kohor, nuk plotësojnë kushtin e natyrës së ngjashme ose nuk dëshmojnë me referenca të sakta dhe të verifikueshme.

Andaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ky pretendim të aprovohet si i bazuar, të konstatohet shkelja e evidentuar dhe të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore për rivlerësimin e ofertës së OE-së së rekomanduar.

Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së AK-së në Pretendimin nr. 3.1

Përgjigjja e Autoritetit Kontraktues lidhur me Pretendimin nr. 3 është e pasaktë, e përgjithshme dhe nuk i trajton në mënyrë konkrete mospërputhjet e evidentuara nga GOE ynë lidhur me kontratat dhe referencat e OE-së së rekomanduar për kontratë.

Kërkesa e përcaktuar në Dosjen e Tenderit ka qenë e qartë: “OE duhet të dëshmojë se ka kryer projekte të natyrës së ngjashme në lëmin e DDDsë, të realizuara / përfunduara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi)”. Pra, nuk ka mjaftuar vetëm dorëzimi i një liste kontratash, por kontratat është dashur të jenë njëkohësisht të natyrës së ngjashme në lëmin e DDD-së, të realizuara/përfunduara brenda periudhës 3-vjeçare nga data e publikimit të njoftimit dhe të dëshmuara me referenca apo dëshmi të sakta dhe të verifikueshme.

AK në përgjigjen e saj vetëm konstaton se OE i rekomanduar ka dorëzuar listën e kontratave në vlerë 85,344.19 €, së bashku me referenca dhe dëshmi, mirëpo nuk ka analizuar në mënyrë përmbajtësore nëse secila kontratë e deklaruar e plotëson kushtin kohor 3-vjeçar, kushtin e natyrës së ngjashme me shërbimet DDD dhe kushtin e vlerës së dëshmuar me referencë valide.

Fakti që disa prej kontratave mund të jenë me autoritete publike dhe mund të verifikohen përmes platformës elektronike të prokurimit nuk nënkupton automatikisht se ato i plotësojnë kërkesat e Dosjes së Tenderit. Një kontratë mund të ekzistojë si kontratë publike, por megjithatë të mos pranohet për këtë kriter nëse është jashtë periudhës së kërkuar, nëse nuk është e natyrës së ngjashme me shërbimet DDD, ose nëse referenca nuk e dëshmon periudhën dhe vlerën e deklaruar nga OE i rekomanduar.

AK nuk ka dhënë përgjigje konkrete për faktin se në listën e OE-së së rekomanduar janë përfshirë kontrata që kanë përfunduar para periudhës së pranueshme 3-vjeçare. Këto kontrata nuk mund të llogariten për përmbushjen e kërkesës së DT-së, pavarësisht se janë paraqitur në listë nga OE i rekomanduar.

Po ashtu, AK nuk ka dhënë përgjigje konkrete për mospërputhjet ndërmjet datave dhe vlerave të deklaruara në listën e kontratave dhe referencave të dorëzuara. Në rastet ku lista deklaron një periudhë apo vlerë të caktuar, ndërsa referenca dëshmon periudhë apo vlerë tjetër, AK ka qenë i obliguar ta trajtojë këtë si mospërputhje materiale dhe jo ta pranojë automatikisht listën e OE-së së rekomanduar.

Gjithashtu, AK nuk ka arsyetuar pse ka pranuar si kontrata të natyrës së ngjashme edhe kontrata që nuk lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit. Kërkesa e Dosjes së Tenderit nuk ka qenë për çfarëdo kontrate publike apo shërbim të përgjithshëm, por për projekte të natyrës së ngjashme në lëmin e DDD-së.

Përgjigjja e AK-së se Komisioni i Vlerësimit “ka mundur të kërkojë sqarime” por nuk e ka parë të nevojshme, nuk e arsyeton pranimin e dokumentacionit me mospërputhje. Përkundrazi, kjo tregon se AK nuk ka bërë verifikim të mjaftueshëm, edhe pse kishte para vetes pretendime konkrete dhe dokumente që tregonin mospërputhje ndërmjet listës së kontratave dhe referencave të dorëzuara.

Nëse AK pretendon se këto kontrata kanë mundur të verifikohen përmes platformës elektronike e-prokurimi, atëherë AK ka pasur detyrim që ta bëjë këtë verifikim në mënyrë të plotë para se ta shpallë OE-në e rekomanduar si të përgjegjshëm. Vetë mundësia e verifikimit nuk është e mjaftueshme; AK është dashur të konstatojë qartë se cilat kontrata janë brenda periudhës 3-vjeçare, cilat janë të natyrës së ngjashme në lëmin e DDD-së dhe cilat vlera janë të dëshmuara me referenca të vlefshme.

Thirrja e AK-së në nenin 59.4 të LPP-së nuk e mbështet vendimin e AK-së, por përkundrazi e obligon AK-në që ta konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse ai është në përputhje me të gjitha kërkesat e paraqitura në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë. Në rastin konkret, AK nuk ka dëshmuar se kontratat e OE-së së rekomanduar i plotësojnë të gjitha kërkesat e kriterit për kontrata të ngjashme.

Për këtë arsye, arsyetimi i AK-së është i pamjaftueshëm, sepse nuk i rrëzon pretendimet tona konkrete, por vetëm e përsërit qëndrimin se OE i rekomanduar e ka plotësuar kriterin.

Një konstatim i tillë i përgjithshëm nuk mund të zëvendësojë vlerësimin real të dokumenteve, datave, vlerave, periudhave dhe natyrës së kontratave të deklaruara.

Rrjedhimisht, duke qenë se një pjesë e kontratave të OE-së së rekomanduar janë jashtë periudhës 3-vjeçare, një pjesë nuk janë të natyrës së ngjashme në lëmin e DDD-së, ndërsa disa të tjera kanë mospërputhje ndërmjet listës dhe referencave, AK nuk ka pasur bazë që ta konsiderojë këtë kërkesë si të përmbushur.

Andaj, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë se arsyetimi i AK-së për Pretendimin nr. 3 është i pasaktë, i përgjithshëm dhe i paqëndrueshëm, pasi nuk i trajton mospërputhjet konkrete të evidentuara nga GOE ynë. Rrjedhimisht, kërkojmë që ky pretendim të aprovet si i bazuar dhe të konstatohet se OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar në mënyrë të qartë, të saktë dhe të verifikueshme përmbushjen e kërkesës për projekte të natyrës së ngjashme në lëmin e DDD-së, të realizuara/përfunduara në tri vitet e shkuara, në vlerë së paku 40,000.00 €.

Pretendimi 3.2

Bazuar në listën e kontratave të dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, duke marrë për bazë se Njoftimi për Kontratë është publikuar më 04.05.2026, periudha 3-vjeçare e pranueshme për kontratat e realizuara fillon nga data 04.05.2023. Prandaj, kontratat që kanë përfunduar para kësaj date nuk mund të llogariten si kontrata të realizuara brenda 3 viteve të fundit dhe nuk mund të përdoren për përmbushjen e kërkesës së Dosjes së Tenderit.

Lista e kontratave e OE te rekomanduar per kontrate:

Nr.	Titulli i Kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës	Data e përfundimit të kontratës	Vlera e ekzekutuar	Emri i Blerstit	E-mail i blersit	Nr. i Telefonit të blersit
1.	Sherbimet e Dezinsektimit, Deratizimit, Dezinsektim ne KRU. PRISHTINA	11.08.2021	10.08.2024	5,760.00 €	Komuna e Prishtinës	Dp.prokurimi@kur-prishtina.com	038603766
2.	Sherbime veterinare ne teren – Lot 17 – Komuna e Vushtrrise – Pjesa trete	27.11.2019	26.11.2022	30459.00 €	AVU-it	jeton.gashi@rks-gov.net	03820038349
3.	D.D.D në hapsirat e kompanis QTA SHPK	06.07.2022	05.09.2022	514.00 €	Komuna Mitrovic	www.qta-mitrovica.com	+38349274700
4.	Sherbimet e DDD ne hapsirat e QTA-SHPK	06.09.2022	05.12.2022	754.78	Komuna e Mitrovices	www.qta-mitrovica.com	+38349274700
5.	Sherbimet e deratizimit, dezinfektimit, desinsektimit per SHPMFPF (2500m2), ISSH (2700m2), SHFSH (300m2), zyret rajonale te pensioneve, ZP dhe QAP-se, Objekti qe shfrytzohe me qira Rr. Tring Ismaili nr. 201.-22-3872-2-3-6	10.08.2022	09.08.2024	4133.40 €	MFPT	feti.ibishi@rks-gov.net minavere.gerguri@rks-gov.net	038 200 34 144 038 200 34 219
6.	Sherbimet e dezinfektimit ne Kuvendin e Republikes se Kosoves	05.08.2021	04.08.2023	842.77 €	Kuvendi i Kosoves	www.kuvendikosoves.org	038 212898
7.	Sherbimet e Dezinsektimit. Dezinsektimi, Deratizimi ne QTA-SHPK	01.02.2022	31.01.2023	990.00 €	Komuna e Mitrovices	www.qta-mitrovica.com	+38349274700
8.	Sherbimet e DDD per nevojat e Komunes se Vushtrrise	23.02.2023	26.04.2024	3,135.68 €	Komuna Vushtrri	prokurimi.vushtrri@rks-gov.net	028/571-218
9.	Sherbimet e dezinfektimit ne ATK	27.07.2020	26.07.2023	22,143.96 €	ATK - Prishtinë	prokurimit@atk-ks.org	038 200 25010
10.	Identifikimi dhe regjistrimi i qeneve me pronar ne teritorin e Republikes se Kosoves	06.10.2022	05.10.2023	2850.00 €	AVU-it	jeton.gashi@rks-gov.net	03820038349
11.	Marrja ne shfrytzim te paisjeve me sensor per sperkatje te duareve me dezinfektues dhe sherbimet e dezinfektimit general te objektit	27.04.2022	26.04.2026	6989.76 €	Gjykata Kushtesuese e Kosoves	vahide.hoxha@gjk.ks.org	+38360162174
12.	Sgherbimet e dezinfektimit, desinsektimit dhe deratizimit DDD	18.10.2024	18.09.2025	6770.84 €			
				Totali:	85,344.19 €		

Nga lista e kontratave të OE-së së rekomanduar, kontratat që nuk e plotësojnë kushtin kohor të periudhës 3-vjeçare janë:

- Kontrata nr. 2 – “Shërbime veterinarë në teren – Lot 17 – Komuna e Vushtrrisë – Pjesa tretë”
Data e nënshkrimit të kontratës: 27.11.2019
Data e përfundimit të kontratës: 26.11.2022
Vlera e deklaruar: 30,459.00 €

Kjo kontratë ka përfunduar më 26.11.2022, pra para datës 04.05.2023. Për këtë arsye, nuk hyn në periudhën 3-vjeçare të kërkuar dhe nuk mund të llogaritet për përmbushjen e kërkesës për kontrata të ngjashme të realizuara brenda tre viteve të fundit pasi që vet titulli I kontratës është Shërbime veterinarë në teren dhe nuk ka te beje me shërbime DDD .

- Kontrata nr. 3 – “D.D.D. në hapësirat e kompanisë QTA SH.P.K.”
Data e nënshkrimit të kontratës: 06.07.2022
Data e përfundimit të kontratës: 05.09.2022
Vlera e deklaruar: 514.00 €

Kjo kontratë ka përfunduar më 05.09.2022, pra jashtë periudhës 3-vjeçare të kërkuar. Si e tillë, nuk mund të pranohet si dëshmi valide për përmbushjen e kriterit të kontratave të ngjashme.

- Kontrata nr. 4 – “Shërbime DDD në hapësirat e QTA-SHPK”
Data e nënshkrimit të kontratës: 06.09.2022
Data e përfundimit të kontratës: 05.12.2022
Vlera e deklaruar: 754.78 €

Kjo kontratë ka përfunduar më 05.12.2022, pra para periudhës së pranueshme 3-vjeçare. Për rrjedhojë, nuk mund të llogaritet në vlerën totale të kontratave të ngjashme të realizuara.

- Kontrata nr. 7 – “Shërbime të Dezinfektimit, Dezinfektimit, Deratizimi në QTA-SHPK”
Data e nënshkrimit të kontratës: 01.02.2022
Data e përfundimit të kontratës: 31.01.2023
Vlera e deklaruar: 990.00 €

Kjo kontratë ka përfunduar më 31.01.2023, pra para datës 04.05.2023. Prandaj, nuk hyn në periudhën 3-vjeçare dhe nuk mund të përdoret për përmbushjen e kërkesës së Dosjes së Tenderit.

Në përfundim, nga vetë lista e kontratave e dorëzuar nga OE i rekomanduar, së paku kontratat nr. 2, nr. 3, nr. 4 dhe nr. 7 nuk e plotësojnë kushtin kohor të periudhës 3-vjeçare, sepse kanë përfunduar para datës 04.05.2023. Për këtë arsye, vlerat e këtyre kontratave duhet të përjashtohen nga llogaritja e kapacitetit teknik/profesional për kontrata të ngjashme të realizuara.

Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së AK-së në Pretendimin nr. 3.2

Përgjigjja e Autoritetit Kontraktues ndaj Pretendimit nr. 3.2 është e përgjithshme, e pasaktë dhe nuk e trajton fare në mënyrë konkrete pretendimin tonë lidhur me kontratat e OE-së së rekomanduar të cilat janë jashtë periudhës 3-vjeçare të kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Kërkesa e përcaktuar në Dosjen e Tenderit ka qenë e qartë: **“OE duhet të dëshmojë se ka kryer projekte të natyrës së ngjashme në lëmin e DDDsë, të realizuara përfunduar në tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi)”**.

Duke qenë se Njoftimi për Kontratë është publikuar me datë **04.05.2026**, periudha 3-vjeçare e pranueshme për kontratat e realizuara/përfunduara fillon nga data **04.05.2023**.

Për rrjedhojë, çdo kontratë e përfunduar para datës 04.05.2023 nuk mund të llogaritet për përmbushjen e kërkesës së Dosjes së Tenderit.

Në pretendimin tonë kemi evidentuar qartë se në listën e kontratave të OE-së së rekomanduar janë përfshirë kontrata që kanë përfunduar para datës 04.05.2023, përkatësisht jashtë periudhës 3-vjeçare të kërkuar. Këto kontrata, pavarësisht se mund të jenë të listuara nga OE i rekomanduar, nuk mund të pranohen si dëshmi valide për këtë kriter, sepse nuk plotësojnë kushtin kohor të përcaktuar në DT.

AK në përgjigjen e saj nuk ka dhënë asnjë sqarim konkret se cilat kontrata i ka konsideruar brenda periudhës 3-vjeçare, cilat i ka përjashtuar nga llogaritja dhe mbi çfarë baze ka arritur në përfundimin se OE i rekomanduar e ka përmbushur vlerën prej së paku 40,000.00 €. Në vend të analizës konkrete, AK vetëm ka deklaruar në mënyrë të përgjithshme se OE i rekomanduar ka dorëzuar listë kontratash në vlerë 85,344.19 €.

Ky arsyetim nuk është i mjaftueshëm, sepse vlera e deklaruar në listë nuk mund të pranohet automatikisht pa u verifikuar nëse kontratat janë të realizuara/përfunduara brenda periudhës së kërkuar, nëse janë të natyrës së ngjashme në lëmin e DDD-së dhe nëse janë të dëshmuara me referenca të sakta. Lista e kontratave nuk e zëvendëson detyrimin e AK-së për vlerësim real dhe përmbajtësor të secilës kontratë.

Fakti që AK ka dhënë një përgjigje të përbashkët për pretendimet 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 3.7 dhe 3.8 tregon se nuk i ka shqyrtuar pretendimet tona pikë për pikë dhe nuk ka dhënë arsyetim konkret për secilën mospërputhje të ngritur. Një përgjigje e tillë e përgjithshme nuk mund të konsiderohet shqyrtim objektiv dhe përmbajtësor i kërkesës sonë për rishqyrtim.

Për më tepër, pretendimi i AK-së se disa kontrata mund të verifikohen përmes platformës elektronike e-prokurimi nuk e ndryshon faktin se kontratat jashtë periudhës 3-vjeçare nuk mund të pranohen për përmbushjen e këtij kriteri. Verifikimi në e-prokurim mund të dëshmojë ekzistencën e kontratës, por nuk mund ta bëjë të pranueshme një kontratë që nuk hyn brenda periudhës kohore të kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Prandaj, pranimi nga AK i kontratave jashtë periudhës 3-vjeçare si pjesë e vlerës prej 85,344.19 € paraqet vlerësim të gabuar, të paarsyetuar dhe në kundërshtim me kërkesën e DT-së. AK ka qenë i obliguar të bëjë ndarjen e kontratave të pranueshme dhe të papranueshme, dhe vetëm kontratat e realizuara/përfunduara brenda periudhës së kërkuar të llogariten për përmbushjen e kriterit prej së paku 40,000.00 €.

Andaj, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë se arsyetimi i AK-së për Pretendimin nr. 3.2 është i përgjithshëm, i pasaktë dhe i paqëndrueshëm, pasi nuk trajton konkretisht kontratat e OE-së së rekomanduar që janë jashtë periudhës 3-vjeçare. Rrjedhimisht, kërkojmë që ky pretendim të aprovohet si i bazuar dhe të konstatohet se kontratat e përfunduara para datës 04.05.2023 nuk mund të llogariten për përmbushjen e kërkesës së DT-së për projekte të natyrës së ngjashme në lëmin e DDD-së, në vlerë së paku 40,000.00 €. Si pasojë, kërkojmë që të vlerësohet se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit për kontrata/projekte të natyrës së ngjashme dhe, si i tillë, nuk është dashur të vlerësohet si i përgjegjshëm për këtë kriter.

Pretendimi 3.3


Kontrata nr. 1 – KRU “Prishtina”: OE i rekomanduar ka deklaruar kontratë deri më 10.08.2024, ndërsa referenca e dorëzuar është e vitit 2022 dhe nuk mund të dëshmojë realizimin e punëve për vitet 2023–2024

Në listën e kontratave të dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, kontrata me KRU “Prishtina” është paraqitur me datë të nënshkrimit 11.08.2021, datë të përfundimit 10.08.2024 dhe vlerë të ekzekutuar 5,760.00 €.

Mirëpo, referenca e dorëzuar për këtë kontratë është lëshuar më 26.10.2022. Kjo referencë nuk mund të dëshmojë kryerjen e shërbimeve për periudhën 2023 dhe 2024, sepse në kohën kur është lëshuar referenca, këto periudha ende nuk kishin ndodhur. Pra, OE i rekomanduar e ka paraqitur në listën e kontratave një periudhë dhe një vlerë sikur kontrata të ishte realizuar deri në vitin 2024, ndërsa dëshmia e dorëzuar nuk e mbulon këtë periudhë.

Kjo paraqet mospërputhje të qartë ndërmjet listës së kontratave dhe referencës së dorëzuar. Një referencë e datës 26.10.2022 nuk mund të përdoret si dëshmi për shërbime që pretendohet se janë realizuar në vitet 2023 dhe 2024. Për këtë arsye, kjo kontratë nuk mund të llogaritet në

vlerën e plotë të deklaruar nga OE i rekomanduar pasi që referenca është për punët e kryera në vlerën 2,880.00 eu.



Pranimi i kësaj kontrate nga AK si dëshmi valide tregon vlerësim tërësisht joprofesional, favorizues dhe të papranueshëm. Komisioni i Vlerësimit dhe Drejtori i Prokurimit kanë pasur

detyrim minimal të krahasojnë datën e referencës me periudhën e deklaruar në listën e kontratave. Mosidentifikimi i një mospërputhjeje kaq të dukshme nuk mund të arsyetohet si gabim teknik, por paraqet dështim serioz dhe trajtim favorizues ndaj OE-së së rekomanduar. Andaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ky pretendim të aprovohet si i bazuar, të konstatohet shkelja e evidentuar dhe të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore për rivlerësimin e ofertës së OE-së së rekomanduar.

Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së AK-së në Pretendimin nr. 3.3

Përgjigjja e AK-së lidhur me këtë pretendim është e përgjithshme dhe nuk e trajton mospërputhjen konkrete të evidentuar nga GOE ynë lidhur me kontratën nr. 1 – KRU “Prishtina”.

OE i rekomanduar ka deklaruar në listën e kontratave se kontrata me KRU “Prishtina” ka zgjatur deri më 10.08.2024 dhe ka vlerë të ekzekutuar 5,760.00 €. Mirëpo, referenca e dorëzuar për këtë kontratë është lëshuar më 26.10.2022 dhe dëshmon punë të kryera vetëm në vlerën 2,880.00 €. Një referencë e lëshuar në vitin 2022 nuk mund të dëshmojë realizimin e shërbimeve për vitet 2023 dhe 2024, sepse këto periudha ende nuk kishin ndodhur në kohën e lëshimit të referencës.

AK nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret se mbi çfarë baze e ka pranuar vlerën 5,760.00 € të deklaruar nga OE i rekomanduar, kur dëshmia e dorëzuar mbulon vetëm vlerën 2,880.00 €. Po ashtu, AK nuk ka sqaruar pse ka pranuar periudhën deri më 10.08.2024, kur referenca e dorëzuar është e datës 26.10.2022.

Prandaj, pranimi i kësaj kontrate në vlerën e plotë të deklaruar paraqet vlerësim të pasaktë dhe të paarsyetuar. Lista e kontratave nuk mund të ketë përparësi ndaj referencës, kur referenca vetë e kufizon periudhën dhe vlerën e dëshmuar.

Andaj, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë se arsyetimi i AK-së për Pretendimin nr. 3.3 është i pasaktë dhe i paqëndrueshëm, pasi nuk trajton mospërputhjen ndërmjet listës së kontratave dhe referencës së dorëzuar. Rrjedhimisht, kërkojmë që kjo kontratë të mos llogaritet në vlerën 5,760.00 €, por vetëm në vlerën e dëshmuar me referencë, përkatësisht 2,880.00 €, dhe të vlerësohet se OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar në mënyrë të saktë përbushjen e kërkesës së DT-së për kontrata të ngjashme.

Pretendimi Nr.3.4:

Kontrata nr. 6 – Kuvendi i Kosovës: OE i rekomanduar ka deklaruar në listë periudhë deri më 04.08.2023, ndërsa referenca dëshmon se kontrata ka përfunduar më 04.08.2022

Në listën e kontratave, OE i rekomanduar ka paraqitur kontratën me Kuvendin e Kosovës me periudhë 05.08.2021 deri më 04.08.2023 dhe me vlerë të ekzekutuar 842.77 €.

Mirëpo, në referencën e lëshuar nga Kuvendi i Kosovës, figuron qartë se kohëzgjatja e kontratës ka qenë nga 05.08.2021 deri më 04.08.2022. Pra, OE i rekomanduar ka deklaruar në listën e kontratave një datë përfundimit të rreme që nuk përputhet me referencën zyrtare të dorëzuar nga vetë ai.

Kjo nuk është paqartësi e thjeshtë, por deklarim i rreme në dokumentin zyrtar të listës së kontratave. OE i rekomanduar ka zgjatur artificialisht periudhën e kontratës në listën e dorëzuar, duke e paraqitur si kontratë që hyn në periudhën e pranueshme, ndërsa referenca e rrëzon këtë pretendim dhe dëshmon se kontrata ka përfunduar më herët.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Me kërkesë të operatorit ekonomik SV, VETERINA, Vushtrri, nëshojmë këtë:

REFERENCË

Prishtinë
31.08.2022
Nr. i ref. 9/2022

Përmes kësaj letër reference¹, konfirmojmë se operatori ekonomik SV, VETERINA, Vushtrri, Rr. e Çamërisë (E-mail: obulanca1@gmail.com; Tel. +383 44 147 297; numri fiskal: 600244347), është shpërblyer me kontratën kornizë për njësi: Furnizimi me material barkues preventues, Lot 2 - Shërbime të dezinfektimit, me numër prokurimi: 101-21-948-1-2-1 (KU101 21 005 121).

- Vlera e realizuar e kontratës: 842.77 €.
- Kohëzgjatja e kontratës: 05.08.2021 deri 04.08.2022.

Operatori ekonomik SV, VETERINA, Vushtrri, për lëndën e cekur më lart, shërbimet i ka kryer sipas kushteve të parapara në Dosje të Tenderit dhe në kontratë.



Me respekt,

Xhemal Halili

Drejtori i Drejtorisë për Prokurim

Në këtë rast, AK ka pranuar një dokument me mospërputhje të qartë faktike. Komisioni i Vlerësimit nuk ka mundur ta konsiderojë këtë kontratë valide pa e vërejtur se data në listën e kontratave dhe data në referencë nuk përputhen. Ky veprim tregon qartë standard favorizues ndaj OE-së së rekomanduar, sepse një mospërputhje e tillë, nëse do të gjendej në ofertën tonë, do të përdorej menjëherë si arsye eliminimi. Andaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ky pretendim të aprovet si i bazuar, të konstatohet shkelja e evidentuar dhe të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore për rivlerësimin e ofertës së OE-së së rekomanduar.

Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së AK-së në Pretendimin nr. 3.4

Përgjigjja e AK-së lidhur me Pretendimin nr. 3.4 është e përgjithshme dhe nuk e trajton mospërputhjen konkrete ndërmjet listës së kontratave dhe referencës së dorëzuar për kontratën me Kuvendin e Kosovës.

OE i rekomanduar ka deklaruar në listën e kontratave se kontrata me Kuvendin e Kosovës ka zgjatur nga 05.08.2021 deri më 04.08.2023, ndërsa referenca zyrtare e dorëzuar nga vetë OE i rekomanduar dëshmon qartë se kontrata ka zgjatur nga 05.08.2021 deri më 04.08.2022. Pra, data e përfundimit e deklaruar në listë nuk përputhet me dokumentin mbështetës.

Kjo mospërputhje është materiale, sepse ndikon drejtpërdrejt në vlerësimin nëse kontrata hyn apo jo në periudhën 3-vjeçare të kërkuar në Dosjen e Tenderit. Lista e kontratave nuk mund të pranohet si e saktë kur vetë referenca zyrtare e rrëzon periudhën e deklaruar në listë.

AK nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret pse e ka pranuar këtë kontratë si të vlefshme, pavarësisht mospërputhjes së qartë ndërmjet datës së deklaruar në listë dhe datës së konfirmuar në referencë. Një përgjigje e përgjithshme se OE i rekomanduar ka dorëzuar listë dhe referenca nuk e zëvendëson detyrimin e AK-së për të verifikuar saktësinë e secilës dëshmi.

Komisioni i Vlerësimit dhe Drejtori i Prokurimit kanë pasur para vetes një referencë ku periudha e kryerjes së shërbimeve ishte e shënuar qartë. Pavarësisht kësaj, ata e kanë trajtuar OE-në e rekomanduar si të përgjegjshëm. Kjo nuk tregon vetëm pakujdesi, por tejkallim të një shkeljeje thelbësore që ka ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin e aktivitetit të prokurimit.

Andaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ky pretendim të aprovohet si i bazuar, të konstatohet shkelja e evidentuar dhe të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore për rivlerësimin e ofertës së OE-së së rekomanduar.

Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së AK-së në Pretendimin nr. 3.5

Përgjigjja e AK-së lidhur me Pretendimin nr. 3.5 është e përgjithshme dhe nuk e trajton mospërputhjen konkrete ndërmjet listës së kontratave dhe referencës së dorëzuar për kontratën me Administratën Tatimore të Kosovës.

OE i rekomanduar ka deklaruar në listën e kontratave se kontrata me ATK ka zgjatur nga 27.07.2020 deri më 26.07.2023 dhe ka vlerë të ekzekutuar 22,143.96 €. Mirëpo, referenca e dorëzuar nga ATK është e datës 07.05.2021 dhe në të specifikohet qartë se shërbimet janë kryer në periudhën 16.03.2020 – 13.07.2020.

Pra, referenca nuk e mbështet deklarinimin e bërë në listën e kontratave. Përkundrazi, ajo dëshmon se shërbimet janë kryer në vitin 2020, shumë jashtë periudhës 3-vjeçare të kërkuar në Dosjen e Tenderit.

AK nuk ka dhënë asnjë arsytim konkret pse e ka pranuar këtë kontratë në vlerën 22,143.96 €, kur dokumenti mbështetës nuk dëshmon realizimin e kësaj kontrate brenda periudhës së pranueshme. Lista e kontratave nuk mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme kur referenca zyrtare e dorëzuar e kundërshton periudhën e deklaruar.

Kjo mospërputhje është materiale dhe ndikon drejtpërdrejt në përmbushjen e kriterit prej së paku 40,000.00 € për kontrata/projekte të natyrës së ngjashme në lëmin e DDD-së. Prandaj, pranimi i kësaj kontrate nga AK si dëshmi valide paraqet vlerësim të pasaktë dhe të paarsyetuar.

Andaj, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë se arsytimi i AK-së për Pretendimin nr. 3.5 është i pasaktë dhe i paqëndrueshëm, pasi nuk trajton mospërputhjen konkrete ndërmjet listës së kontratave dhe referencës së dorëzuar nga ATK. Rrjedhimisht, kërkojmë që ky pretendim të konsiderohet i bazuar, kjo kontratë të mos llogaritet si dëshmi valide për përmbushjen e kërkesës së DT-së, si dhe të vlerësohet se OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar në mënyrë të saktë dhe të verifikueshme përmbushjen e kriterit për kontrata/projekte të natyrës së ngjashme.

Pretendimi Nr.3.6

Kontrata nr. 10 – AVU: kontrata për identifikimin dhe regjistrimin e qenve me pronar nuk është kontratë e natyrës së ngjashme me shërbimet DDD

Në listën e kontratave, OE i rekomanduar ka paraqitur kontratën me titull “Identifikimi dhe regjistrimi i qenve me pronar në territorin e Republikës së Kosovës”, me datë të nënshkrimit 06.10.2022, datë të përfundimit 05.10.2023 dhe vlerë të deklaruar 2,850.00 €.

Edhe pse kjo kontratë mund të jetë brenda periudhës kohore, ajo nuk është e natyrës së ngjashme me shërbimet e kërkuara në këtë aktivitet të prokurimit. Lënda e këtij tenderi është Dezinfektimi, Dezinsektimi, Deratizimi (DDD) dhe largimi i zvarranikëve brejtësve, ndërsa identifikimi dhe regjistrimi i qenve me pronar është veprimtari tjetër, administrative/veterinare, dhe nuk përbën shërbim DDD.

Prandaj, kjo kontratë nuk mund të llogaritet në vlerën e kontratave të ngjashme. Kërkesa e DT/NJK nuk ka qenë për çfarëdo shërbimi veterinar apo aktivitet të përgjithshëm, por për kontrata të natyrës së ngjashme me shërbimet DDD. Përfshirja e kësaj kontrate në listën e kontratave për të rritur artificialisht vlerën totale paraqet deklaram të pasaktë dhe tentim për të paraqitur kapacitet teknik që realisht nuk lidhet me objektin e prokurimit.

AK e ka pasur të qartë nga vetë titulli i kontratës se kjo kontratë nuk lidhet me DDD. Megjithatë, Komisioni i Vlerësimit e ka anashkalar këtë fakt dhe e ka trajtuar ofertën e OE-së së rekomanduar si të përgjegjshme. Ky është vlerësim qartazi favorizues, sepse AK ka pranuar si të ngjashme një kontratë që nga vetë titulli nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me shërbimet DDD.

Andaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ky pretendim të aprovohet si i bazuar, të konstatohet shkelja e evidentuar dhe të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore për rivlerësimin e ofertës së OE-së së rekomanduar.

Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së AK-së në Pretendimin nr. 3.6

Përgjigja e AK-së lidhur me Pretendimin nr. 3.6 është e përgjithshme dhe nuk e trajton çështjen kryesore të këtij pretendimi: natyrën reale të kontratës nr. 10 me AVU.

OE i rekomanduar ka paraqitur kontratën me titull “Identifikimi dhe regjistrimi i qenve me pronar në territorin e Republikës së Kosovës”, në vlerë 2,850.00 €. Edhe nëse kjo kontratë mund të jetë brenda periudhës kohore, ajo nuk është kontratë e natyrës së ngjashme në lëmin e DDD-së, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Lënda e aktivitetit të prokurimit është Dezinfektimi, Dezinsektimi, Deratizimi (DDD) dhe largimi i zvarranikëve brejtësve ndërsa identifikimi dhe regjistrimi i qenve me pronar është aktivitet tjetër administrativ/veterinar dhe nuk përbën shërbim DDD.

AK nuk ka dhënë asnjë arsytim konkret se pse një kontratë për identifikimin dhe regjistrimin e qenve duhet të konsiderohet e ngjashme me shërbimet DDD. Një përgjigje e përgjithshme se OE i rekomanduar ka dorëzuar listë kontratash dhe referenca nuk mjafton për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri.

Prandaj, kjo kontratë nuk mund të llogaritet në vlerën e kontratave/projekteve të natyrës së ngjashme. Pranimi i saj nga AK si kontratë e ngjashme paraqet vlerësim të pasaktë dhe të paarsyetuar.

Andaj, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë se arsytimi i AK-së për Pretendimin nr. 3.6 është i pasaktë dhe i paqëndrueshëm, pasi nuk trajton faktin se kontrata nr. 10 me AVU nuk është e natyrës së ngjashme në lëmin e DDD-së. Rrjedhimisht, kërkojmë që ky pretendim të konsiderohet i bazuar, kjo kontratë të mos llogaritet si dëshmi valide për përmbushjen e kërkesës së DT-së, si dhe të vlerësohet se OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar në mënyrë të saktë përmbushjen e kriterit për kontrata/projekte të natyrës së ngjashme.

Pretendimi Nr.3.7

Kontrata nr. 11 – Gjykata Kushtetuese: kontrata është për marrjen në shfrytëzim të pajisjeve/sensorëve dhe jo për kontratë të ngjashme DDD në kuptimin e kërkesës së DT/NJK Në listën e kontratave, OE i rekomanduar ka paraqitur kontratën me Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, me titull “Marrja në shfrytëzim të pajisjeve me sensor për spërkatje të duarve me dezinfektues dhe shërbimet e dezinfektimit gjeneral të objektit”, me datë 27.04.2022 deri më 26.04.2026 dhe vlerë të deklaruar 6,898.76 €.

Mirëpo, nga referenca e dorëzuar rezulton se objekti kryesor i kësaj kontrate lidhet me marrjen në shfrytëzim të pajisjeve me sensor për spërkatje të duarve me dezinfektues, pra me pajisje dhe furnizim/shfrytëzim të pajisjeve, e jo me shërbime të natyrës së plotë DDD siç kërkohet në Dosjen e Tenderit.

Për më tepër, referenca nuk dëshmon vlerën e plotë të deklaruar në listë. Në referencë figuron se vlera e shpenzuar deri më 25.04.2025 është 4,465.68 €, ndërsa në listë është deklaruar vlera 6,898.76 €. Pra, edhe në këtë rast kemi mospërputhje ndërmjet vlerës së deklaruar në listën e kontratave dhe asaj që dëshmohet me referencë.

Kjo kontratë nuk mund të pranohet në vlerën dhe natyrën që e ka deklaruar OE i rekomanduar. Ajo nuk dëshmon kontratë të ngjashme DDD në kuptimin e kërkesës së DT/NJK dhe nuk e mbështet vlerën e deklaruar në listën e kontratave. Përfshirja e saj në listë si kontratë e ngjashme paraqet deklaram të pasaktë dhe rritje artificiale të vlerës së kontratave të pretenduara.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 20.06.2025

Mbështetur në nenin 81, paragrafi 1, të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-092 dhe bazuar në nenin 70.23 të Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin Publik, menaxherja e kontratës, znj. Gjylsha Metaj, lëshon këtë:

Letër Referencë

për vlerësimin e përfomancës për kontratën me numër: 243238-22-2270-2-2-1/C59

Kontraktuesi “S.V. Veterina”, ka marrëdhënie kontraktuese me Zyrën e Prokurimit të Gjykatës Kushtetuese, përkritazi për shërbimin: “Marrje në shfrytëzim të pajisjeve me sensor për spërkatje të duarve me dezinfektues dhe shërbimet e dezinfektimit gjeneral të objektit” - Kontratë publike kornizë.

Kontrata është nënshkruar me datë 27 prill 2022 dhe ka përfunduar me 26 prill 2025.

Vlera totale indikativë e kontratës është: 6,989.76 €, ndërsa vlera e shpenzuar deri më 25 prill 2025 është: 4,465.68 €.

Treguesi i përfomancës deri në fund të kontratës ka qenë i shkëlqyeshëm.

Kontraktuesi i ka kryer shërbimet e dezinfektimit gjeneral të objektit dhe mbushjen e pajisjeve me sensor për spërkatje të duarve me dezinfektues në objektin e Gjykatës Kushtetuese, në pajtim me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

Menaxherja e Kontratës
Gjylsha Metaj

AK, Drejtori i Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit e kanë pranuar këtë dokument pa e analizuar natyrën reale të kontratës dhe pa e krahasuar vlerën e deklaruar me vlerën e dëshmuar në referencë. Ky veprim përbën vlerësim favorizues dhe selektiv, sepse një kontratë që nuk e plotëson qartë natyrën dhe vlerën e kërkuar është përdorur për ta mbajtur artificialisht OE-në e rekomanduar si të përgjegjshëm.

Andaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ky pretendim të aprovohet si i bazuar, të konstatohet shkelja e evidentuar dhe të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore për rivlerësimin e ofertës së OE-së së rekomanduar.

Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së AK-së në Pretendimin nr. 3.7

Përgjigjja e AK-së lidhur me Pretendimin nr. 3.7 është e përgjithshme dhe nuk e trajton konkretisht natyrën reale të kontratës me Gjykatën Kushtetuese dhe mospërputhjen ndërmjet vlerës së deklaruar në listë dhe vlerës së dëshmuar me referencë.

OE i rekomanduar ka paraqitur kontratën me titull “Marrja në shfrytëzim të pajisjeve me sensor për spërkatje të duarve me dezinfektues dhe shërbimet e dezinfektimit gjeneral të objektit”, në vlerë të deklaruar 6,898.76 €. Mirëpo, nga vetë titulli dhe përmbajtja e referencës rezulton se pjesa kryesore e kontratës lidhet me marrjen në shfrytëzim të pajisjeve/sensorëve për dezinfektim të duarve, dhe jo me shërbime të natyrës së plotë DDD, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Për më tepër, referenca nuk e dëshmon vlerën e plotë të deklaruar nga OE i rekomanduar. Në referencë figuron se vlera e shpenzuar deri më 25.04.2025 është 4,465.68 €, ndërsa në listën e kontratave është deklaruar vlera 6,898.76 €. Kjo paraqet mospërputhje konkrete ndërmjet listës dhe dokumentit mbështetës.

AK nuk ka dhënë asnjë arsyetim se pse kjo kontratë është trajtuar si kontratë e natyrës së ngjashme në lëmin e DDD-së dhe pse është pranuar në vlerën e plotë të deklaruar, kur referenca dëshmon vlerë tjetër. Një përgjigje e përgjithshme se OE i rekomanduar ka dorëzuar listë dhe referenca nuk e zëvendëson detyrimin e AK-së për të vlerësuar përmbajtjen, natyrën dhe vlerën reale të kontratës.

Prandaj, kjo kontratë nuk mund të llogaritet në natyrën dhe vlerën e deklaruar nga OE i rekomanduar. Pranimi i saj nga AK si dëshmi valide paraqet vlerësim të pasaktë dhe të paarsyetuar.

Andaj, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë se arsyetimi i AK-së për Pretendimin nr. 3.7 është i pasaktë dhe i paqëndrueshëm, pasi nuk trajton natyrën reale të kontratës dhe mospërputhjen e vlerës së deklaruar me vlerën e dëshmuar në referencë. Rrjedhimisht, kërkojmë që ky pretendim të konsiderohet i bazuar, kjo kontratë të mos llogaritet si dëshmi valide në vlerën dhe natyrën e deklaruar, si dhe të vlerësohet se OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar në mënyrë të saktë përmbushjen e kriterit për kontrata/projekte të natyrës së ngjashme në lëmin e DDD-së.

Pretendimi Nr.3.8

Përfundim për kontratat që në listë janë paraqitur si valide, por referencat i rrëzojnë deklaratimet e OE-së së rekomanduar

Nga analizimi i kontratave nr. 1, nr. 6, nr. 9, nr. 10 dhe nr. 11 rezulton se OE i rekomanduar ka paraqitur në listën e kontratave të dhëna të pasakta, periudha të pambështetura nga referencat, vlera të padëshmuara dhe kontrata që nuk janë të natyrës së ngjashme me shërbimet DDD. Këto nuk janë gabime të parëndësishme. Këto janë mospërputhje materiale, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në përmbushjen e kriterit prej së paku 40,000.00 € për kontrata të ngjashme të realizuara. Nëse këto kontrata hiqen nga llogaritja, OE i rekomanduar nuk e përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit.

Prandaj, deklarimi i OE-së së rekomanduar në listën e kontratave se ka realizuar 85,344.19 € kontrata të ngjashme nuk qëndron. Ky deklarim është i rremë/pasaktë në raport me dokumentet mbështetëse të dorëzuara nga vetë OE, dhe AK ka pasur detyrim ta identifikojë këtë gjatë vlerësimit.

Fakti që ju si Komision i Vlerësimit, Drejtor i Prokurimit dhe Autoritet Kontraktues i keni kaluar këto mospërputhje dhe e keni rekomanduar këtë OE për kontratë dëshmon vlerësim të njëanshëm, favorizues dhe në kundërshtim me parimet e prokurimit publik. AK nuk mund të pretendojë se ka bërë vlerësim objektiv kur ka pranuar si valide kontrata që vetë referencat e dorëzuara i kundërshtojnë.

Ky veprim përbën standard të dyfishtë të hapur: GOE ynë është eliminuar mbi bazën e interpretimeve të ngushta dhe formale, ndërsa OE i rekomanduar është pranuar pavarësisht deklarimeve të pasakta, mospërputhjeve të dukshme dhe kontratave që nuk e përmbushin kriterin material të DT/NJK. Një vlerësim i tillë nuk mund të konsiderohet i ligjshëm, objektiv apo i paanshëm, por përbën favorizim të qartë të OE-së së rekomanduar për kontratë.

Andaj, kërkojmë nga ju si Autoritet Kontraktues ket pretendim ta aprovoni si i bazuar, dhe të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore për vlersimin e drejte te ksaj procedure te prokurimit.

Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së AK-së në Pretendimin nr. 3.8

Përgjigjja e AK-së lidhur me Pretendimin nr. 3.8 është e përgjithshme dhe nuk e trajton përfundimin kryesor të këtij pretendimi: se kontratat e paraqitura nga OE i rekomanduar në listë nuk përputhen me referencat dhe dokumentet mbështetëse të dorëzuara nga vetë ai.

Nga analizimi i kontratave nr. 1, nr. 6, nr. 9, nr. 10 dhe nr. 11 rezulton se OE i rekomanduar ka deklaruar periudha, vlera dhe natyrë të kontratave që nuk mbështeten nga referencat përkatëse. Disa kontrata janë jashtë periudhës 3-vjeçare, disa nuk janë të natyrës së ngjashme në lëmin e DDD-së, ndërsa disa të tjera kanë mospërputhje të qarta ndërmjet listës dhe referencave.

AK nuk ka dhënë arsyetim konkret se si, pas përjashtimit të këtyre kontratave të kontestuara, OE i rekomanduar ende e përmbush kërkesën prej së paku 40,000.00 € për kontrata/projekte të natyrës së ngjashme. Thjesht deklarimi se OE i rekomanduar ka paraqitur listë në vlerë 85,344.19 € nuk mjafton, kur dokumentet mbështetëse nuk e dëshmojnë këtë vlerë në mënyrë të saktë dhe të verifikueshme.

Një listë kontratash nuk mund të pranohet automatikisht si dëshmi valide nëse referencat e dorëzuara e kundërshtojnë periudhën, vlerën ose natyrën e kontratave të deklaruara. AK ka

pasur detyrim të bëjë vlerësim përmbajtësor të secilës kontratë dhe të përjashtojë nga llogaritja ato kontrata që nuk përmbushin kërkesat e DT-së.

Përgjigjja e përgjithshme e AK-së nuk i rrëzon mospërputhjet konkrete të evidentuara nga GOE ynë dhe nuk dëshmon se OE i rekomanduar e ka përmbushur realisht kriterin për kontrata të ngjashme. Përkundrazi, mosadresimi i këtyre mospërputhjeve tregon vlerësim të mangët dhe jo objektiv.

Andaj, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë se arsyetimi i AK-së për Pretendimin nr. 3.8 është i pasaktë, i përgjithshëm dhe i paqëndrueshëm. Rrjedhimisht, kërkojmë që ky pretendim të konsiderohet i bazuar dhe të vlerësohet se OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar në mënyrë të qartë, të saktë dhe të verifikueshme përmbushjen e kërkesës së DT-së për kontrata/projekte të natyrës së ngjashme në lëmin e DDD-së, në vlerë së paku 40,000.00 €.

Pretendimi Nr.4:

Pretendimi Nr.4.1:

Ne, Grupi i Operatorëve Ekonomik Best D.D.D. SH.P.K.; Shaqir Brahimi B.I.; Vlera SH.P.K., pas qasjes në dokumentacionin e OE-së së rekomanduar për kontratë, kemi hasur në një fakt shumë shqetësues dhe me peshë serioze për ligjshmërinë e kësaj procedure të prokurimit.

Në dokumentacionin e OE-së së rekomanduar për kontratë gjendet fatura nr. 32/2020, e datës 15.10.2020, e lëshuar nga “Korabi Company” SH.P.K. për S.V. “Veterina” Safet Osmani B.I. Në këtë faturë, disa pajisje janë të emërtuara me formulime pothuajse identike me emërtimet e pajisjeve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit, konkretisht në Aneksin 8 – Lista e Pajisjeve dhe Mekanizimit të Obligueshëm.

Në faturën nr. 32/2020 të OE-së së rekomanduar figurojnë, ndër të tjera, këto pajisje:

- “Pomp elektrike ULV 220V”;
- “Fungator për Ambient Bren/UL”;
- “Autonizer mjegullues për DD”;
- “Nobelizator ULV i vogël”.

Ndërsa në Dosjen e Tenderit, te Aneksi 8 – Lista e Pajisjeve dhe Mekanizimit të Obligueshëm, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar, ndër të tjera:

- “Fungator për ambiente të brendshme”;
- “Pomp elektrike ULV 220 V”.

Përputhja pothuajse identike ndërmjet emërtimeve të pajisjeve në faturën e OE-së së rekomanduar dhe emërtimeve të përdorura nga AK në Dosjen e Tenderit nuk mund të kalohet si rastësi e thjeshtë pa u sqaruar. Përkundrazi, kjo krijon dyshim serioz dhe të arsyeshëm se specifikimet teknike të pajisjeve në DT mund të jenë hartuar ose përshtatur duke marrë për bazë pajisjet ekzistuese të OE-së së rekomanduar për kontratë.

Ky dyshim bëhet edhe më serioz kur merret parasysh se i njëjti OE është rekomanduar për kontratë, ndërsa GOE ynë është eliminuar mbi bazën e interpretimeve të zgjeruara dhe formale të AK-së. Pra, nga njëra anë AK ka vendosur kërkesa teknike me emërtime që përputhen me faturat e OE-së së rekomanduar, ndërsa nga ana tjetër ka eliminuar ofertën tonë dhe ka rekomanduar pikërisht operatorin ekonomik pajisjet e të cilit përkojnë me terminologjinë e përdorur në DT.

Një veprim i tillë, nëse nuk sqarohet dhe verifikohet në mënyrë të plotë, paraqet indikacion të fortë për favorizim, përshtatje të specifikimeve teknike dhe cenim të konkurrencës së lirë. Në këtë rast, përdorimi i emërtimeve pothuajse identike me ato që gjenden në faturën e OE-së së rekomanduar krijon përshtypjen se kërkesat teknike nuk janë hartuar në mënyrë të pavarur dhe neutrale, por janë orientuar në mënyrë që t'i përshtaten një operatori të caktuar. Kjo është në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik, përfshirë transparencën, trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin dhe sigurimin e konkurrencës së ndershme.

AK nuk mund ta trajtojë këtë çështje si të parëndësishme, sepse bëhet fjalë për përputhje konkrete ndërmjet dokumenteve të OE-së së rekomanduar dhe kërkesave të Dosjes së Tenderit. Nëse AK nuk e sqaron burimin e këtyre emërtimeve teknike dhe arsyen pse ato përputhen me faturat e OE-së së rekomanduar, atëherë mbetet dyshimi serioz se DT është përgatitur në mënyrë favorizuese dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Për më tepër, Komisioni i Vlerësimit dhe Drejtori i Prokurimit nuk kanë mundur të mos e vërejnë këtë përputhje gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të OE-së së rekomanduar. Fatura nr. 32/2020 dhe Aneksi 8 i DT-së përmbajnë emërtime të qarta dhe të krahasueshme. Prandaj, mosadresimi i këtij fakti nga AK, së bashku me rekomandimin e të njëjtit OE për kontratë, e forcon edhe më shumë dyshimin për vlerësim favorizues dhe jo objektiv.

Dëshmi për këtë pretendim janë:

1. Fatura nr. 32/2020, datë 15.10.2020, e lëshuar nga “Korabi Company” SH.P.K. për S.V. “Veterina” Safet Osmani B.I., ku figurojnë pajisjet me emërtimet “Pomp elektrike ULV 220V” dhe “Fungator për Ambient Bren/UL”;
2. Aneksi 8 i Dosjes së Tenderit – Lista e Pajisjeve dhe Mekanizimit të Obligueshëm, ku AK ka kërkuar “Fungator për ambiente të brendshme” dhe “Pomp elektrike ULV 220 V”.

KORABI Company Shpk
 Vushtrri, Rr. e Titos 01,
 +379 28 271 756; +379 44 555-473
 NRID: 70147017
 Shifra: 316009472000144 (ProCredit Bank),
 TVSH 330065848 Nr Unik 810690162


FAKTURA

Nr. 32/2020
Data: 15.10.2020

Bloresi: S.V. VETERINA Safet Osmani B.I.
 Emri: Vushtrri
 Adresa: Vushtrri
 NR Faktat: 810692857

(Ky Aneks është obligativ që të plotësohet dhe ti bashkëngjiten dëshmit e kerkuara ne FTD)

Nr.	Pershkrimi	Sasia	Cenimi për TVSH	%	Cënimi me TVSH	Vite
1	Autonizier mjegullues për DD	4	15.25	18	18.00	
2	Pomp elektrike ULV 220V	3	29.66	18	35.00	
3	Robotizator ULV i vogël	2	32.20	18	38.00	
4	Fungator për Ambient Bren/UL	2	27.11	18	32.00	
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
14						

Pranoi: 
 Emri dhe mbiemri
 Nenshkrimi

KC
 Faturë
 KORABI COMPANY
 VUSHTRRI

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Njësi (copë)	Sasia e kërkuar
1	Pompë motorike – generator ULV (vëllim Ultra i Ulët/ Ultra Low Volume) për dezinspektimin hapësiror të jashtëm.	Copë	2
2	Pompa motorike LV (Low Volume) të krahut për dezinspektimin hapësiror të jashtëm.	Copë	10
3	Automjete pune për vendosjen e pompave gjeneratorëve ULV dhe pompave power sprayer për kryerje të shërbimit të dezinspektimit hapësiror të jashtëm për spërkatje në largësi. - (minimum Një (1) SUV - Xhip transportues me rimorik për Dezinspektim)	Copë	1
4	Automjete për bartjen e punëtorëve dhe pajisjeve tjera përcjellëse për kryerje të shërbimeve të dezinspektimit hapësiror të jashtëm. - (minimum 2 (dy) Pikap për transportin e punëtorëve)	Copë	2
5	Pomp elektrike ULV për ambiente të brendshme	Copë	5
6	Pomp motorike me benzin ULV	Copë	5
7	Fungator për ambiente të brendshme	Copë	1
8	Pomp elektrike ULV 220 V	Copë	1

Një listë të mjeteve apo pajisjeve teknike që janë në dispozicionin tuaj për të çekzektuar kontratën në fjalë- pajisjet e makineria në dispozicion duhet të dëshmohen me kopje të librezave mbi pronsin e tyre ose DUD-I doganore, ose fatura e

Duke marrë parasysh këtë përputhje të drejtpërdrejtë, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të sqarojë burimin e specifikimeve teknike të pajisjeve në Dosjen e Tenderit dhe të tregojë nëse gjatë hartimit të këtyre specifikimeve janë përdorur informata, dokumente, këshilla, mostra, fatura apo instruksione nga OE i rekomanduar për kontratë ose nga persona të lidhur me të.

Në mungesë të një sqarimi bindës dhe të dokumentuar nga AK, kjo përputhje duhet të trajtohet si indikacion serioz i përshtatjes së specifikimeve teknike në favor të OE-së së rekomanduar për kontratë. Për këtë arsye, kërkojmë që ky pretendim të aprovet si i bazuar, të anulohet vendimi për rekomandim të OE-së S.V. “Veterina”, dhe procedura të kthehet në rivlerësim të plotë, duke verifikuar edhe mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike në Dosjen e Tenderit.

Në rast se Autoriteti Kontraktues nuk i shqyrton në mënyrë serioze, objektive dhe përmbajtësore pretendimet tona, dhe nëse vazhdon ta mbrojë vendimin për rekomandimin e OE-së S.V. “Veterina” pavarësisht këtyre indicieve serioze për përshtatje të specifikimeve teknike, favorizim dhe cenim të konkurrencës së lirë, ne si Grup i Operatorëve Ekonomik do të ndjekim të gjitha rrugët ligjore në dispozicion përmes organeve përkatëse kompetente. Kjo përfshin, pa u kufizuar, ushtrimin e mjeteve juridike pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit, njoftimin e institucioneve mbikëqyrëse të prokurimit publik, si dhe inicimin e çdo procedure tjetër të lejuar ligjërisht për verifikimin e përgjegjësisë së personave dhe zyrtarëve të përfshirë në hartimin, vlerësimin dhe miratimin e kësaj procedure të prokurimit. Çdo mosveprim i AK-së ndaj këtyre pretendimeve do të konsiderohet nga ana jonë si vazhdim i vlerësimit të njëanshëm dhe favorizues në dëm të GOE-së tonë dhe në dëm të parimeve themelore të prokurimit publik.

Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së AK-së në Pretendimin nr. 4.1

Përgjigjja e AK-së lidhur me Pretendimin nr. 4.1 është e përgjithshme dhe nuk e trajton fare thelbin e pretendimit tonë, përkatësisht dyshimin serioz për përputhjen pothuajse identike ndërmjet emërtimeve të pajisjeve në faturën nr. 32/2020 të OE-së së rekomanduar dhe emërtimeve të përdorura nga AK në Aneksin 8 të Dosjes së Tenderit.

AK në përgjigjen e saj vetëm konstaton se OE i rekomanduar ka dorëzuar listën e pajisjeve, faturat dhe dëshmitë e pronësisë, mirëpo nuk jep asnjë sqarim lidhur me burimin e specifikimeve teknike të vendosura në Dosjen e Tenderit dhe nuk e sqaron pse këto emërtime përputhen pothuajse fjalë për fjalë me pajisjet e paraqitura në faturën e OE-së së rekomanduar.

Pretendimi ynë nuk ka të bëjë vetëm me faktin nëse OE i rekomanduar ka dorëzuar apo jo dokumente për pajisje, por me dyshimin se specifikimet teknike të DT-së mund të jenë hartuar ose përshtatur duke marrë për bazë pajisjet ekzistuese të OE-së së rekomanduar. Kjo është çështje serioze që lidhet me transparencën, konkurrencën e lirë dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Për këtë arsye, përgjigjja e AK-së se Komisioni i Vlerësimit nuk e ka parë të nevojshme të kërkojë sqarime nuk është e mjaftueshme. Në rastin konkret, AK është dashur të sqarojë burimin e emërtimeve teknike në Aneksin 8 dhe të tregojë nëse gjatë hartimit të specifikimeve janë përdorur informata, dokumente, mostra, fatura apo udhëzime nga OE i rekomanduar ose persona të lidhur me të.

Fakti që AK nuk e ka trajtuar këtë çështje në mënyrë konkrete e bën arsyetimin e saj të pamjaftueshëm dhe të paqëndrueshëm. Një përgjigje e përgjithshme për pajisjet nuk mund ta rrëzojë pretendimin tonë për mundësinë e përshtatjes së specifikimeve teknike në favor të OE-së së rekomanduar.

Andaj, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë se arsyetimi i AK-së për Pretendimin nr. 4.1 është i përgjithshëm, i pasaktë dhe nuk e trajton çështjen thelbësore të ngritur nga GOE ynë. Rrjedhimisht, kërkojmë që ky pretendim të konsiderohet i bazuar dhe të verifikohet në mënyrë të plotë nëse specifikimet teknike të pajisjeve në Dosjen e Tenderit janë hartuar në mënyrë neutrale, transparente dhe pa favorizim të OE-së së rekomanduar për kontratë.

Pretendimi 4.2

OE i rekomanduar nuk i ka përmbushur kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit lidhur me pajisjet dhe mekanizimin e obligueshëm

Ne, Grupi i Operatorëve Ekonomik Best D.D.D. SH.P.K.; Shaqir Brahimi B.I.; Vlera SH.P.K., kontestojmë vlerësimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me pranimin si të rregullt të dokumentacionit të OE-së së rekomanduar për kontratë, S.V. “Veterina”, për sa i përket pajisjeve dhe mekanizimit të obligueshëm të kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të OE-së së rekomanduar, kemi konstatuar se i njëjti ka dorëzuar katalog/listë të pajisjeve ku ka deklaruar posedimin e disa pompave motorike. Në këtë katalog, OE i rekomanduar ka paraqitur këto pajisje:

- Pompë motorike STIHL ULV – 2 copë;
- Pompë motorike Villager DM14PE – 2 copë;
- Pompë motorike Hyundai Turbo 900 – 2 copë;
- Gjithsej pompa motorike të deklaruara – 5 copë.

Që në këtë pikë vërehet një mospërputhje e qartë në vetë deklarinimin e OE-së së rekomanduar, sepse sipas pajisjeve të listuara rezultojnë 6 copë, ndërsa OE i rekomanduar i ka paraqitur si gjithsej 5 copë. Kjo tregon se katalogu/lista e pajisjeve është i pasaktë, i paqartë dhe nuk mund të pranohet si dokument i besueshëm pa verifikim të plotë nga Komisioni i Vlerësimit.

Për më tepër, në dokumentin tjetër të dorëzuar nga OE i rekomanduar me titull “Pajisjet për DDD – fatura dhe dëshmi që posedojmë në pronësi”, nuk janë dorëzuar dëshmi për të gjitha pajisjet e deklaruara në katalog. Nga ky dokument rezulton se OE i rekomanduar ka dhënë dëshmi vetëm për:

- Spërkatëse me benzin Hyundai T900 – 2 copë;
- Power Sprayer me kapacitet 200 litra – 1 copë;
- Makinë Power Sprayer me kapacitet 700 litra – 2 copë;
- Spërkatëse motorike DM-14PE – 2 copë.

Pra, ekziston mospërputhje e qartë ndërmjet pajisjeve të deklaruara në katalog dhe pajisjeve për të cilat janë dorëzuar dëshmi pronësie/posedimi. OE i rekomanduar ka deklaruar pajisje në katalog, mirëpo nuk ka dorëzuar dëshmi të plota për to. Në veçanti, për pajisjet “Pompë motorike STIHL ULV – 2 copë”, të cilat janë deklaruar në katalog, nuk rezulton të jetë dorëzuar faturë, DUD doganor, librezë pronësie apo ndonjë dëshmi tjetër e vlefshme që vërteton pronësinë ose posedimin e tyre.

Ky fakt dëshmon se OE i rekomanduar nuk i ka përmbushur kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit. DT nuk ka kërkuar vetëm deklaram formal të pajisjeve në katalog, por ka kërkuar që pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm të jenë në dispozicion të OE-së dhe të dëshmoen me dokumente përkatëse, si faturë, DUD doganor, librezë pronësie apo dëshmi tjetër të pranueshme.

Katalogu nuk është dëshmi pronësie. Një listë e përgatitur nga vetë OE nuk mund të zëvendësojë dokumentet që dëshmojnë posedimin real të pajisjeve. Prandaj, pajisjet e deklaruara nga OE i rekomanduar, për të cilat nuk janë dorëzuar dëshmi pronësie apo posedimi, nuk mund të pranohen si të vlefshme për përmbushjen e kërkesave teknike të DT-së.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton qartë se OE i rekomanduar nuk është as afër përmbushjes së kërkesave të publikuara në DT lidhur me pajisjet dhe mekanizimin e obligueshëm. Një pjesë e pajisjeve janë vetëm të deklaruara, por jo të dëshmuara; një pjesë tjetër nuk përputhet me emërtimet dhe kërkesat e DT-së; ndërsa dokumentacioni i pronësisë nuk e mbështet katalogun e paraqitur nga OE.

Kjo mospërputhje është thelbësore, sepse pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm përbëjnë kapacitet teknik të domosdoshëm për realizimin e kontratës. Nëse OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar posedimin e pajisjeve të kërkuara, ai nuk mund të konsiderohet i përgjegjshëm dhe nuk ka pasur bazë ligjore të rekomandohet për kontratë.

Autoriteti Kontraktues, Komisioni i Vlerësimit dhe Drejtori i Prokurimit kanë pasur detyrim të bëjnë krahasimin ndërmjet tri dokumenteve kryesore: kërkesave të Aneksit 8 të DT-së, katalogut/listës së pajisjeve të OE-së së rekomanduar dhe faturave/dëshmime të pronësisë të dorëzuara nga i njëjti OE. Ky krahasim do ta nxirrte menjëherë në pah se dokumentacioni i OE-së së rekomanduar është i paplotë, i pasaktë dhe nuk dëshmon përmbushjen e kërkesave të DT-së.

Pavarësisht kësaj, AK e ka pranuar këtë dokumentacion si të rregullt dhe e ka shpallur OE-në e rekomanduar të përgjegjshëm. Ky është vlerësim qartazi favorizues dhe jo objektiv. AK ka anashkaluar mungesën e dëshmime për pajisjet e deklaruara, ka tejkaluar mospërputhjet ndërmjet katalogut dhe faturave, dhe ka pranuar deklarime të pambështetura me prova.

Është e papranueshme që ndaj GOE-së tonë AK të aplikojë standard tepër të ashpër dhe eliminues, ndërsa ndaj OE-së së rekomanduar të pranojë dokumentacion teknik të paplotë dhe të pasaktë. Ky trajtim i pabarabartë tregon se Komisioni i Vlerësimit nuk ka bërë vlerësim të drejtë dhe të paanshëm, por ka vepruar në mënyrë që të mbajë në procedurë OE-në e rekomanduar, pavarësisht se dokumentet e tij nuk i përmbushin kërkesat e DT-së. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një paqartësi të vogël administrative, por me mungesë të dëshimit të kapacitetit teknik të kërkuar. OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar se i posedon të gjitha pajisjet e deklaruara dhe të kërkuara. Për rrjedhojë, oferta e tij është dashur të vlerësohet si e papërgjegjshme.

Prandaj, kërkojmë që ky pretendim të aprovohet si i bazuar dhe të konstatohet se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka përmbushur kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit lidhur me pajisjet dhe mekanizimin e obligueshëm. Rrjedhimisht, oferta e OE-së S.V. “Veterina” nuk është dashur të vlerësohet si e përgjegjshme dhe rekomandimi për dhënie të kontratës këtij operatori ekonomik duhet të anulohet.

Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së AK-së në Pretendimin nr. 4.2

Përgjigjja e AK-së lidhur me Pretendimin nr. 4.2 është krejtësisht e përgjithshme, formale dhe e pamjaftueshme. AK nuk ka shqyrtuar në mënyrë përmbajtësore pretendimet tona të mbështetura me fakte dhe argumente, por ka dhënë një përgjigje vetëm për ta kaluar formalisht procedurën e shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim.

Në këtë pretendim, GOE ynë ka paraqitur qartë se OE i rekomanduar nuk ka dorëzuar dëshmi të plota dhe të vlefshme për pajisjet e kërkuara në Dosjen e Tenderit. Ne kemi evidentuar mospërputhje konkrete ndërmjet katalogut/listës së pajisjeve të deklaruara nga OE i rekomanduar dhe faturave/dëshmime të pronësisë të dorëzuara prej tij. Përkundër kësaj, AK nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete për këto mospërputhje.

AK është mjaftuar me një konstatim të përgjithshëm se OE i rekomanduar ka dorëzuar listën e pajisjeve, faturat dhe dëshmitë, por nuk ka treguar se cilat pajisje të kërkuara në DT janë dëshmuar me dokumente valide, cilat nuk janë dëshmuar, dhe si është bërë krahasimi ndërmjet Aneksit 8 të DT-së, katalogut të OE-së dhe faturave/dëshmime të dorëzuara.

Ky nuk është vlerësim objektiv dhe profesional. Nëse AK do ta kishte shqyrtuar realisht dokumentacionin, do të konstatonte menjëherë se katalogu/lista e pajisjeve nuk përputhet me dëshmitë e pronësisë, se disa pajisje janë vetëm të deklaruara dhe jo të dëshmuara, si dhe se për pajisje të caktuara të paraqitura në katalog nuk janë dorëzuar fatura, DUD doganor apo dëshmi tjetër e pranueshme.

Në veçanti, AK nuk ka dhënë asnjë sqarim për pajisjet “Pompë motorike STIHL ULV – 2 copë”, të deklaruara në katalog nga OE i rekomanduar, për të cilat nuk rezulton të jenë dorëzuar dëshmi të vlefshme pronësie apo posedimi. Katalogu i përgatitur nga vetë OE nuk mund të konsiderohet dëshmi pronësie dhe nuk mund të zëvendësojë faturën, DUD-in doganor apo dokumentin tjetër që vërteton posedimin real të pajisjes.

Përgjigjja e AK-së se Komisioni i Vlerësimit nuk e ka parë të nevojshme të kërkojë sqarime është e papranueshme. Kur dokumentacioni i OE-së së rekomanduar përmban mospërputhje kaq të qarta ndërmjet pajisjeve të deklaruara dhe dëshmime të dorëzuara, AK ka pasur detyrim minimal që t’i verifikojë këto dokumente dhe të mos e shpallë automatikisht OE-në e rekomanduar si të përgjegjshëm.

Në këtë rast, AK nuk ka bërë vlerësim real të kapacitetit teknik të OE-së së rekomanduar, por ka anashkaluar mungesën e dëshmime për pajisjet e kërkuara në DT. Ky veprim përbën vlerësim të njëanshëm, favorizues dhe në kundërshtim me trajtimin e barabartë, sepse ndaj GOE-së tonë AK ka aplikuar standard të ashpër eliminues, ndërsa ndaj OE-së së rekomanduar ka pranuar dokumentacion të paplotë, të pasaktë dhe të pambështetur me prova.

Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm nuk janë elemente formale, por përbëjnë kapacitet teknik thelbësor për realizimin e kontratës. Nëse OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar posedimin e pajisjeve të kërkuara, ai nuk ka përmbushur kërkesat e DT-së dhe nuk është dashur të vlerësohet si i përgjegjshëm.

Andaj, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë se përgjigjja e AK-së për Pretendimin nr. 4.2 është formale, e përgjithshme dhe e paqëndrueshme, pasi nuk trajton faktet dhe dëshmitë konkrete të paraqitura nga GOE ynë. Rrjedhimisht, kërkojmë që ky pretendim të

konsiderohet i bazuar, të konstatohet se OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme posedimin e pajisjeve dhe mekanizimit të obligueshëm të kërkuar në Dosjen e Tenderit, dhe si pasojë oferta e tij të vlerësohet si e papërgjegjshme për këtë kriter.

Pretendimi Nr.4.3

DUD doganor i paplotë dhe i pamjaftueshëm si dëshmi pronësie/posedimi

OE i rekomanduar ka dorëzuar DUD doganor për pajisje të ndryshme, mirëpo dokumenti është dorëzuar i paplotë, pasi mungon faqja e parë ku dëshmohen të dhënat kryesore të DUD-it, përfshirë importuesin, deklaruesin, numrin e deklaratës doganore dhe të dhënat identifikuese të subjektit. Në mungesë të këtyre të dhënave, nuk mund të vërtetohet se pajisjet janë importuar nga S.V. “Veterina” apo se ato i takojnë realisht këtij operatori ekonomik.

Prandaj, ky DUD doganor nuk mund të pranohet si dëshmi valide për pronësinë apo posedimin e pajisjeve të kërkuara në DT. Dorëzimi i një dokumenti doganor pa faqen kryesore krijon dyshim serioz për fshehje të të dhënave thelbësore dhe për tentim të paraqitjes së pajisjeve si pronë e OE-së së rekomanduar, pa e dëshmuar këtë fakt. AK dhe Komisioni i Vlerësimit e kanë pranuar këtë dokument të paplotë në mënyrë të pajustificueshme dhe favorizuese, duke e vlerësuar ofertën e OE-së së rekomanduar si të përgjegjshme, ndonëse dëshmia nuk e provon importuesin dhe pronësinë e pajisjeve.

Andaj kerkojme nga ju si AK te merrni si te bazuar kete pretendim.

Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së AK-së në Pretendimin nr. 4.3

Përgjigjja e AK-së lidhur me Pretendimin nr. 4.3 është e përgjithshme, formale dhe nuk e trajton thelbin e pretendimit tonë: fakti se OE i rekomanduar ka dorëzuar DUD doganor të paplotë, pa faqen kryesore ku vërtetohen të dhënat esenciale të dokumentit doganor.

Në këtë pretendim, GOE ynë ka sqaruar se DUD-i i dorëzuar nga OE i rekomanduar nuk përmban faqen e parë, ku zakonisht figurojnë të dhënat kryesore si importuesi, deklaruesi, numri i deklaratës doganore, të dhënat identifikuese të subjektit dhe elementet bazë që e lidhin dokumentin me operatorin ekonomik. Në mungesë të kësaj faqeje, nuk mund të vërtetohet në mënyrë të qartë dhe të sigurt se pajisjet janë importuar nga S.V. “Veterina” apo se ato i takojnë realisht këtij operatori ekonomik.

Si dëshmi për këtë pretendim, bashkëngjitur paraqesim kopjen e DUD-it doganor të dorëzuar nga OE i rekomanduar, ku vërehet se dokumenti është i paplotë dhe mungon faqja kryesore me të dhënat identifikuese të importuesit dhe deklaratës doganore. [Dëshmia: DUD doganor i paplotë i OE-së së rekomanduar]

Pretendimi Nr. 4.4:

Fatura e EU1 SERVIS nr. 18/2020 për “Gjenerator motorik Ultra Low Volume (ULV)” me çmim 132.00 € për copë është joreale, e pabesueshme dhe nuk dëshmon posedimin real të pajisjes së kërkuar në DT

OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar faturën e EU1 SERVIS, datë 21.02.2020, me nr. 18/2020, në të cilën figuron përshkrimi “Gjenerator motorik Ultra Low Volume (ULV)” me çmim 132.00 € për copë.

Ky çmim është krejtësisht joreal, i pabesueshëm dhe nuk përputhet me vlerën reale të tregut për një pajisje profesionale të tipit gjenerator motorik ULV. Nuk ekziston pajisje profesionale “Gjenerator motorik Ultra Low Volume (ULV)” me çmim 132.00 € për copë, pasi pajisjet e tilla janë pajisje të specializuara për dezinfektim/dezinsektim hapësinor dhe kanë vlerë shumëfish më të lartë.

Në këtë rast, përshkrimi i vendosur në faturë nuk mjafton për të dëshmuar se OE i rekomanduar realisht posedon pajisjen e kërkuar në DT. Përkundrazi, çmimi 132.00 € për copë krijon dyshim serioz se në faturë është vendosur vetëm një përshkrim formal “Gjenerator motorik Ultra Low Volume (ULV)”, me qëllim që dokumenti të paraqitet si dëshmi për pajisjen e kërkuar, ndërsa realisht pajisja e faturuar nuk mund të jetë gjenerator motorik ULV profesional.

Ky dyshim bëhet edhe më i fortë kur krahasohet me dëshmitë tona doganore për pajisje të njëjta apo të ngjashme ULV. Si dëshmi shtesë, kërkojmë që AK të kontrollojë DUD-at doganorë të dorëzuar nga GOE ynë, ku pajisja ULV e importuar nga Best D.D.D. SH.P.K. ka vlerë rreth 7,500.00 €, ndërsa pajisja e Shaqir Brahimi B.I., e dëshmuar po ashtu përmes DUD-it doganor, ka vlerë 4,315.00 €. Këto vlera dëshmojnë qartë se pajisjet profesionale ULV nuk kanë dhe nuk mund të kenë çmim 132.00 € për copë.

Prandaj, dallimi ndërmjet çmimit 132.00 € të paraqitur nga OE i rekomanduar dhe vlerave reale të pajisjeve ULV të dëshmuara përmes DUD-ave doganorë është aq i madh sa nuk mund të trajtohet si dallim normal tregu apo si çështje çmimi. Ky dallim tregon se fatura e OE-së së rekomanduar nuk është dëshmi e besueshme për posedimin e një gjeneratori motorik ULV profesional, por paraqet dokument me përshkrim të dyshimtë dhe çmim joreal.

Nëse pajisja e faturuar me 132.00 € është vërtet “Gjenerator motorik Ultra Low Volume (ULV)”, atëherë çmimi i saj është krejtësisht i papranueshëm dhe i pabesueshëm në raport me vlerën reale të tregut. Ndërsa nëse çmimi 132.00 € është real për pajisjen e faturuar, atëherë pajisja nuk mund të jetë gjenerator motorik ULV profesional siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit. Në të dy rastet, fatura nuk mund të pranohet si dëshmi valide për përmbushjen e kërkesës teknike të DT-së.

AK, Komisioni i Vlerësimit dhe Drejtori i Prokurimit kanë pasur detyrim të verifikojnë këtë mospërputhje të dukshme. Një faturë ku një pajisje profesionale ULV paraqitet me çmim 132.00€ për copë nuk mund të pranohet automatikisht si dëshmi e rregullt. Një vlerësim minimal objektiv do të duhej të ngrinte menjëherë dyshim mbi vërtetësinë, natyrën dhe vlerën reale të pajisjes së paraqitur.

Pavarësisht kësaj, AK e ka pranuar këtë faturë si dëshmi dhe e ka vlerësuar OE-në e rekomanduar si të përgjegjshëm. Ky veprim përbën vlerësim favorizues dhe jo profesional, sepse AK ka tejkaluar një mospërputhje të qartë dhe thelbësore në dokumentacionin e OE-së së rekomanduar, duke pranuar si të vlefshme një faturë që nuk dëshmon realisht posedimin e pajisjes së kërkuar në DT.

Për këtë arsye, kërkojmë që fatura e EU1 SERVIS nr. 18/2020, datë 21.02.2020, të mos pranohet si dëshmi valide për posedimin e gjeneratorit motorik ULV të kërkuar në DT. Po ashtu, kërkojmë që AK të verifikojë dhe krahasojë këtë faturë me DUD-at doganorë të dorëzuar nga GOE ynë, ku vlerat reale të pajisjeve ULV janë rreth 7,500.00 € dhe 4,315.00 €, duke dëshmuar se nuk ekziston gjenerator motorik ULV profesional me çmim 132.00 € për copë.

Rrjedhimisht, OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar në mënyrë të besueshme dhe të vlefshme posedimin e pajisjes së obligueshme ULV, andaj oferta e tij nuk është dashur të vlerësohet si e përgjegjshme dhe rekomandimi për dhënie të kontratës këtij operatori duhet të anulohet. Kërkojmë që ky pretendim të mirret i bazuar.

Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së AK-së në Pretendimin nr. 4.4


Përgjigja e AK-së lidhur me Pretendimin nr. 4.4 është e përgjithshme, e papranueshme dhe nuk e trajton fare mospërputhjen thelbësore të ngritur nga GOE ynë lidhur me faturën e EU1 SERVIS nr. 18/2020, datë 21.02.2020.

OE i rekomanduar ka dorëzuar faturë ku figuron përshkrimi “Gjenerator motorik Ultra Low Volume (ULV)” me çmim 132.00 € për copë. Ky çmim është krejtësisht joreal dhe nuk përputhet me vlerën reale të një pajisjeje profesionale ULV. Sipas dëshmive krahasuese të GOE-së tonë, pajisjet profesionale ULV kanë vlerë shumëfish më të lartë, madje deri rreth 50 herë më të lartë se çmimi i paraqitur nga OE i rekomanduar.

AK ka pasur detyrim minimal profesional që ta verifikojë këtë mospërputhje të dukshme. Një faturë ku një pajisje profesionale ULV paraqitet me çmim 132.00 € nuk mund të pranohet verbërisht si dëshmi valide pa asnjë analizë, pa verifikim të tregut, pa krahasim me DUD-at doganorë dhe pa kërkuar sqarim nga OE i rekomanduar.

Nëse pajisja e faturuar është realisht “Gjenerator motorik Ultra Low Volume (ULV)”, atëherë çmimi 132.00 € është i pabesueshëm dhe kërkon verifikim të domosdoshëm. Nëse çmimi 132.00 € është real për pajisjen e faturuar, atëherë ajo pajisje nuk mund të jetë gjenerator motorik ULV profesional i kërkuar në Dosjen e Tenderit. Në të dy rastet, fatura nuk mund të pranohet si dëshmi e rregullt për përmbushjen e kërkesës teknike.

Si dëshmi për këtë pretendim, bashkëngjitur paraqesim dëshmitë tona krahasuese për vlerën reale të pajisjeve ULV, përfshirë DUD-at doganorë/dëshmitë për pajisjet profesionale ULV të GOE-së tonë, ku vlerat janë dukshëm më të larta se çmimi 132.00 € i paraqitur nga OE i rekomanduar.



Përgjigjja e AK-së nuk sqaron se si është pranuar si e besueshme një faturë me çmim kaq joreal. AK nuk ka treguar se ka bërë ndonjë verifikim, nuk ka dhënë asnjë arsytim teknik dhe nuk ka sqaruar pse një pajisje që realisht kushton shumëfish më shtrenjtë është pranuar si e dëshmuar me faturë prej vetëm 132.00 €.

Ky veprim tregon vlerësim të papërgjegjshëm, joprofesional dhe favorizues. Është e papranueshme që AK, Komisioni i Vlerësimit dhe Drejtori i Prokurimit të pranojnë si të rregullt një faturë me çmim haptazi joreal, ndërsa ndaj GOE-së tonë të aplikojnë standard tepër të ashpër dhe eliminues. Një mospërputhje kaq e madhe nuk mund të anashkalohej si çështje formale apo si dallim normal çmimi, por duhej të trajtohej si sinjal serioz për verifikim të detyrueshëm.

Andaj, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë se arsyetimi i AK-së për Pretendimin nr. 4.4 është i pasaktë, i përgjithshëm dhe i paqëndrueshëm, pasi AK ka pranuar si dëshmi valide një faturë me çmim joreal dhe të pabesueshëm për pajisjen “Gjenerator motorik Ultra Low Volume (ULV)”. Rrjedhimisht, kërkojmë që ky pretendim të konsiderohet i bazuar dhe të vlerësohet se OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar në mënyrë të besueshme posedimin e pajisjes profesionale ULV të kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Pretendimi Nr. 4.5:

OE i rekomanduar nuk ka përmbushur kërkesën e DT-së për minimum 2 automjete “Pikap” për transportin e punëtorëve dhe pajisjeve

Në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar qartë automjete për bartjen e punëtorëve dhe pajisjeve tjera përcjellëse për kryerjen e shërbimeve të dezinfektimit hapësinor të jashtëm, përkatësisht: minimum 2 (dy) Pikap për transportin e punëtorëve.

Kjo kërkesë është e qartë, specifike dhe nuk lë hapësirë për interpretim të zgjeruar. AK nuk ka kërkuar çfarëdo automjeti, nuk ka kërkuar furgon, veturë, kombi apo automjet tjetër të përgjithshëm, por ka kërkuar në mënyrë të shprehur 2 automjete Pikap.

Mirëpo, OE i rekomanduar për kontratë, përmes dokumentit me titull “8.1. Librezat e automjeteve me validitet regj.”, ka dorëzuar libreza të automjeteve ku rezulton se automjetet e paraqitura nuk janë “Pikap”, por Furgon me 4 dyer.

Konkretisht, në faqet 3 dhe 4 të dokumentit të dorëzuar nga OE i rekomanduar shihet automjeti me targa 02-915-EG, ku te përshkrimi/ndërtimi i automjetit figuron qartë: “Furgon me 4 dyer”.

Po ashtu, në faqet 4 dhe 5 të njëjtit dokument shihet automjeti me targa 02-576-FQ, ku te përshkrimi/ndërtimi i automjetit figuron po ashtu qartë: “Furgon me 4 dyer”.

Pra, vetë dëshmitë e dorëzuara nga OE i rekomanduar e konfirmojnë se automjetet e paraqitura nuk janë Pikap, por janë furgonë. Për rrjedhojë, OE i rekomanduar nuk e ka përmbushur kërkesën e vendosur në DT për minimum 2 automjete Pikap.

Kjo nuk është çështje formale apo paqartësi teknike. Lloji i automjetit është element i drejtpërdrejtë i kërkesës së kapacitetit teknik. Kur AK ka kërkuar “Pikap”, operatori ekonomik ka qenë i detyruar të dëshmojë posedimin ose disponimin e automjeteve të këtij lloji. Dorëzimi i librezave për furgonë nuk mund të barazohet me përmbushjen e kërkesës për Pikap.

Nëse AK do të kishte pranuar edhe furgonë apo automjete të tjera të ngjashme, këtë do të duhej ta kishte përcaktuar qartë në Dosjen e Tenderit. Mirëpo, meqenëse kërkesa është formuluar shprehimisht si “minimum 2 Pikap”, atëherë AK nuk ka bazë ligjore që pas hapjes së ofertave ta zgjerojë këtë kërkesë dhe ta trajtojë furgonin si të barasvlershëm me Pikap-in. Autoriteti Kontraktues, Komisioni i Vlerësimit dhe Drejtori i Prokurimit kanë pasur para vetes librezat e automjeteve ku qartë figuron përshkrimi “Furgon me 4 dyer”. Përkundër kësaj, AK e ka vlerësuar OE-në e rekomanduar si të përgjegjshëm, duke e anashkaluar faktin se kërkesa e DT-së për 2 Pikap nuk është përmbushur.

Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së AK-së në Pretendimin nr. 4.5

Përgjigjja e AK-së lidhur me Pretendimin nr. 4.5 është e pasaktë, formale dhe e papranueshme, sepse AK ka anashkaluar një kërkesë shumë të qartë të Dosjes së Tenderit dhe ka pranuar dëshmi që nuk përputhen fare me atë që është kërkuar.

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar shprehimisht: “Automjete për bartjen e punëtorëve dhe pajisjeve tjera përcjellëse për kryerje të shërbimeve të dezinfektimit hapsinor të jashtëm. - (minim 2 (dy) Pikap per transportin e punetoreve)”.

Kjo kërkesë nuk lë hapësirë për interpretim. AK nuk ka kërkuar çfarëdo automjeti, nuk ka kërkuar furgon, kombi, veturë apo automjet tjetër të përgjithshëm, por ka kërkuar saktësisht minimum 2 (dy) Pikap.

Megjithatë, OE i rekomanduar ka dorëzuar librezat për automjete ku qartë figuron se automjetet janë “Furgon me 4 dyer”, konkretisht automjeti me targa 02-915-EG dhe automjeti me targa 02-576-FQ. Pra, vetë dëshmitë e dorëzuara nga OE i rekomanduar tregojnë se nuk janë dorëzuar dëshmi për 2 automjete Pikap, por për dy automjete të tjera, të cilat nuk përputhen me kërkesën e DT-së.

Është e pakuptueshme dhe e papranueshme se si Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni i Vlerësimit e kanë vlerësuar si të përgjegjshme ofertën e OE-së së rekomanduar, kur dëshmitë e dorëzuara nuk e përmbushin kërkesën e përcaktuar qartë në Dosjen e Tenderit. Nëse AK ka kërkuar “Pikap”, atëherë nuk mund të pranojë “Furgon me 4 dyer” si të barasvlershëm, sepse kjo paraqet ndryshim të kërkesës pas hapjes së ofertave.

AK nuk ka të drejtë që gjatë vlerësimit ta zgjerojë apo ta ndryshojë kërkesën e DT-së. Nëse do të pranoheshin edhe furgonë apo automjete të tjera, kjo duhej të ishte përcaktuar qartë në Dosjen e Tenderit. Meqenëse një gjë e tillë nuk është përcaktuar, pranimi i furgonëve si zëvendësim për Pikap përbën interpretim të kundërligjshëm, trajtim favorizues dhe cenim të barazisë në vlerësim.

Ky nuk është gabim formal apo paqartësi teknike. Lloji i automjetit është pjesë e kapacitetit teknik të kërkuar dhe lidhet drejtpërdrejt me mënyrën e kryerjes së shërbimeve në terren. Prandaj, OE i rekomanduar ka qenë i detyruar të dëshmojë posedimin ose disponimin e minimum 2 automjeteve Pikap, e jo të dorëzojë libreza për automjete të tipit furgon. Si dëshmi për këtë pretendim, bashkëngjitur paraqesim librezat e automjeteve të dorëzuara



A	Identifikues i ngjyrosjes Niveli i ngjyrosjes Kod i ngjyrosjes	02-915-EG
I	Data e regjistrimit Data e përcaktimit Data e përcaktimit	07.02.2022
C	Emri i drejtuesit Emri i drejtuesit Emri i drejtuesit	Safet Osmani B.I.
C.2.1	Adresa e drejtuesit Adresa e drejtuesit Adresa e drejtuesit	95, Centralëb Vuçitri
C.2.2	Adresa e drejtuesit Adresa e drejtuesit Adresa e drejtuesit	14.09.2007
C.2.3	Adresa e drejtuesit Adresa e drejtuesit Adresa e drejtuesit	2240
D	Emri i drejtuesit Emri i drejtuesit Emri i drejtuesit	010
D.1	Emri i drejtuesit Emri i drejtuesit Emri i drejtuesit	1830
D.2	Emri i drejtuesit Emri i drejtuesit Emri i drejtuesit	2KN



A	Identifikues i ngjyrosjes Niveli i ngjyrosjes Kod i ngjyrosjes	02-576-FQ
I	Data e regjistrimit Data e përcaktimit Data e përcaktimit	17.03.2022
C	Emri i drejtuesit Emri i drejtuesit Emri i drejtuesit	Safet Osmani B.I.
C.2.1	Adresa e drejtuesit Adresa e drejtuesit Adresa e drejtuesit	95, Centralëb Vuçitri
C.2.2	Adresa e drejtuesit Adresa e drejtuesit Adresa e drejtuesit	15.04.2011
C.2.3	Adresa e drejtuesit Adresa e drejtuesit Adresa e drejtuesit	2175
D	Emri i drejtuesit Emri i drejtuesit Emri i drejtuesit	010
D.1	Emri i drejtuesit Emri i drejtuesit Emri i drejtuesit	1470
D.2	Emri i drejtuesit Emri i drejtuesit Emri i drejtuesit	2KN

Pranimi i këtyre dëshmime nga AK tregon standard të dyfishtë dhe vlerësim qartazi favorizues. Ndaj GOE-së tonë AK ka aplikuar interpretim të rreptë dhe eliminues, ndërsa ndaj OE-së së rekomanduar ka pranuar dëshmi që nuk përputhen fare me kërkesën e publikuar në DT. Ky veprim është i papranueshëm dhe në kundërshtim me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe vlerësimit objektiv.

Andaj, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë se arsyetimi i AK-së për Pretendimin nr. 4.5 është i pasaktë dhe i paqëndrueshëm, pasi AK ka pranuar si të rregullta dëshmi për automjete “Furgon me 4 dyer”, ndonëse në Dosjen e Tenderit janë kërkuar shprehimisht minimum 2 (dy) Pikap. Rrjedhimisht, kërkojmë që ky pretendim të konsiderohet i bazuar dhe të vlerësohet se OE i rekomanduar nuk ka përmbushur kërkesën e DT-së për automjetet e obligueshme, andaj oferta e tij nuk është dashur të vlerësohet si e përgjegjshme për këtë kriter.


Pretendimi Nr. 5:

Pretendimi Nr.5.1:

Diploma e dorëzuar nga OE i rekomanduar për Epidemiolog/Veterinarin/Mjekun Veterinar është e palexueshme

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të OE-së së rekomanduar për kontratë, konkretisht gjatë verifikimit të diplomës së dorëzuar për personin e propozuar si Epidemiolog/Veterinar/Mjek Veterinar, kemi konstatuar se diploma është e palexueshme dhe nuk mund të pranohet si dëshmi valide.

Në këtë diplomë nuk mund të verifikohet qartë emri i personit, emri i fakultetit, data e fillimit dhe përfundimit të studimeve, titulli i fituar, data e lëshimit dhe elementet kryesore që dëshmojnë kualifikimin profesional të kërkuar në DT.



Është e papranueshme që GOE ynë të eliminohet me arsyetime lidhur me diplomën/kualifikimin profesional, ndërsa OE i rekomanduar të vlerësohet si i përgjegjshëm me një diplomë të palexueshme. Ky është standard i dyfishtë dhe vlerësim favorizues nga AK, Komisioni i Vlerësimit dhe Drejtori i Prokurimit.

Prandaj, kërkojmë që kjo diplomë të mos pranohet si dëshmi valide dhe të konstatohet se OE i rekomanduar nuk e ka dëshmuar në mënyrë të qartë dhe të verifikueshme kualifikimin profesional të personit të propozuar.


Kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së AK-së në Pretendimin nr. 5.1

Përgjigja e AK-së lidhur me Pretendimin nr. 5.1 është e pasaktë, e paqëndrueshme dhe tregon qartë standard të dyfishtë në vlerësimin e dokumentacionit të ofertuesve.

AK pretendon se diploma e dorëzuar nga OE i rekomanduar ka qenë e lexueshme dhe e pranueshme për Komisionin e Vlerësimit, mirëpo ky arsyetim nuk qëndron. Nga dokumenti i dorëzuar rezulton se diploma është praktikisht e palexueshme në pjesët kryesore që duhet të dëshmojnë kualifikimin profesional, përfshirë emrin e personit, institucionin/fakultetin, titullin e fituar, datën e lëshimit, numrin e regjistrimit dhe elementet tjera identifikuese që e bëjnë dokumentin të verifikueshëm.

Në dëshminë e bashkëngjitur mund të vlerësohet qartë edhe nga OSHP se diploma e dorëzuar nga OE i rekomanduar është e palexueshme. Nuk shihet qartë emri i personit, titulli i fituar, data e lëshimit, numri i regjistrimit, të dhënat e plota të fakultetit dhe elementet tjera esenciale që e bëjnë një diplomë të verifikueshme si dëshmi profesionale.

Si dëshmi për këtë pretendim, bashkëngjitur paraqesim kopjen e diplomës së dorëzuar nga OE i rekomanduar, ku shihet se dokumenti është i palexueshëm dhe nuk mundëson verifikim të qartë të të dhënave kryesore të kualifikimit profesional. [Dëshmia: Diploma e palexueshme e dorëzuar nga OE i rekomanduar]



Është e papranueshme se si një dokument i tillë, i cili nuk mund të lexohet qartë as nga ne si GOE i interesuar në këtë aktivitet të prokurimit, është konsideruar i lexueshëm dhe i pranueshëm nga AK dhe Komisioni i Vlerësimit. Nëse një dokument nuk mund të verifikohet qartë nga përmbajtja e tij, atëherë ai nuk mund të pranohet si dëshmi valide për përmbushjen e një kriteri profesional të Dosjes së Tenderit.

AK nuk ka dhënë asnjë sqarim konkret se cilat të dhëna i ka lexuar dhe verifikuar nga kjo diplomë, mbi çfarë baze ka konstatuar se dokumenti është i pranueshëm dhe si është bindur se personi i propozuar e plotëson kualifikimin e kërkuar. Deklarimi i thjeshtë se diploma ka qenë “e lexueshme dhe e pranueshme” nuk është arsyetim, por vetëm tentim për ta mbuluar një mangësi të dukshme në dokumentacionin e OE-së së rekomanduar.

Nëse një dokument nuk mund të lexohet qartë dhe nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive, ai nuk mund të pranohet si dëshmi valide për përmbushjen e një kriteri profesional të DT-së. Vlerësimi nuk mund të bazohet në supozime apo në bindjen subjektive të Komisionit të Vlerësimit, por në dokumente të qarta, të lexueshme dhe të verifikueshme.

Ky është standard i dyfishtë i qartë: ndaj GOE-së tonë AK ka aplikuar kriter formal dhe eliminues lidhur me dokumentet e kualifikimit profesional, ndërsa ndaj OE-së së rekomanduar ka pranuar një diplomë të palexueshme, të paverifikueshme dhe të pamjaftueshme si dëshmi të rregullt. Një qasje e tillë nuk mund të konsiderohet vlerësim objektiv, transparent apo i barabartë, por vlerësim selektiv dhe favorizues.

Është veçanërisht e papranueshme që AK ndaj GOE-së tonë ka aplikuar standard shumë të rreptë lidhur me dëshminë e kualifikimit profesional, duke e trajtuar si arsye eliminimi çështjen e diplomës, ndërsa ndaj OE-së së rekomanduar ka pranuar një diplomë të palexueshme si dëshmi të mjaftueshme. Ky është trajtim i pabarabartë, selektiv dhe favorizues.

Për më tepër, nëse AK kishte ndonjë dyshim apo paqartësi lidhur me dokumentin, ishte i obliguar të kërkonte sqarim/verifikim, e jo ta pranonte automatikisht si të rregullt një dokument që nuk mund të lexohet qartë. Pranimi i një dokumenti të tillë si dëshmi valide cenon parimin e transparencës, trajtimit të barabartë dhe vlerësimit objektiv.

Andaj, kërkojmë nga OSHP që ta shqyrtojë vetë dëshminë e bashkangjitur dhe të konstatojë se diploma e dorëzuar nga OE i rekomanduar nuk është e lexueshme dhe nuk dëshmon në mënyrë të qartë e të verifikueshme kualifikimin profesional të personit të propozuar. Rrjedhimisht, kërkojmë që ky pretendim të konsiderohet i bazuar dhe të vlerësohet se OE i rekomanduar nuk e ka përmbushur kërkesën e DT-së për dëshmimin e kualifikimit profesional të personit të propozuar si Epidemiolog/Veterinar/Mjek Veterinar.

Pretendimi Nr. 5.2:

Dyshim serioz për falsifikim/manipulim të certifikatave DDD të dorëzuara nga OE i rekomanduar

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të OE-së së rekomanduar për kontratë, konkretisht dokumentit me titull “6. Staf i profesional dhe Teknik me kon. dhe Certifikata për DDD”, kemi hasur në mospërputhje serioze në certifikatat DDD të dorëzuara, të cilat krijojnë

dyshim të arsyeshëm se këto certifikata mund të jenë të falsifikuara, të manipuluar ose të përgatitura në mënyrë jo të rregullt.

Konkretisht, certifikatat pretendohet se janë lëshuar/certifikuar në të njëjtën ditë për tre persona, mirëpo paraqiten në tri versione të ndryshme. Certifikata e z. Safet Osmani është në gjuhën shqipe dhe angleze, një certifikatë tjetër është pjesërisht në dy gjuhë, ndërsa certifikata tjetër është vetëm në gjuhën shqipe. Një organ certifikues serioz nuk do të duhej të lëshonte në të njëjtën ditë, për të njëjtin trajnim/kurs, certifikata me forma, përmbajtje dhe strukturë të ndryshme për pjesëmarrës të të njëjtit certifikim.

Po ashtu, vërehen mospërputhje edhe te pjesa e nënshkrimeve dhe titujve profesionalë. Në disa certifikata, te nënshkrimi i “ing. teknolog ushqimor” figuron edhe versioni anglisht i kësaj shprehjeje, ndërsa në njëërën prej tyre jo. E njëjta situatë paraqitet edhe te pjesa e nënshkrimit të doktoreshës, ku në dy certifikata figuron edhe përkthimi në gjuhën angleze, ndërsa në njëërën certifikatë mungon. Këto ndryshime janë të pajustificueshme nëse certifikatat janë lëshuar nga i njëjti organ, për të njëjtën ditë dhe për të njëjtin trajnim.

Më shqetësues është fakti se në dy prej certifikatave nënshkrimi duket identik, ndërsa në njëërën certifikatë nënshkrimi ndryshon plotësisht. Nuk është e arsyeshme që nënshkrimi i të njëjtit person përgjegjës, për certifikata të lëshuara në të njëjtën ditë dhe për të njëjtin trajnim, të ndryshojë në mënyrë kaq të dukshme. Kjo mospërputhje e forcon edhe më shumë dyshimin për manipulim të dokumenteve.

Për më tepër, kodi i certifikatës rezulton të jetë i njëjtë në të tri certifikatat. Kjo është një parregullsi thelbësore, pasi secila certifikatë individuale, e lëshuar për persona të ndryshëm, duhet të ketë kod/numër unik identifikues për qëllime verifikimi. Përdorimi i të njëjtit kod në tri certifikata të ndryshme e bën të pamundur verifikimin individual të tyre dhe krijon dyshim serioz mbi autenticitetin e dokumenteve.

Duke marrë parasysh këto mospërputhje — tri versione të ndryshme certifikatash për të njëjtën ditë, dallime gjuhësore në format, dallime në titujt pranë nënshkrimeve, nënshkrime të ndryshme dhe kod të njëjtë në tri certifikata — ne kemi dyshim serioz dhe të bazuar se certifikatat DDD të dorëzuara nga OE i rekomanduar nuk janë dokumente të rregullta dhe nuk është dashur të pranohen nga Autoriteti Kontraktues si dëshmi valide.

AK, Komisioni i Vlerësimit dhe Drejtori i Prokurimit kanë pasur detyrim që këto mospërputhje t'i evidentojnë dhe t'i verifikojnë para se ta vlerësojnë OE-në e rekomanduar si të përgjegjshëm. Pranimi i këtyre certifikatave pa verifikim, pavarësisht mospërputhjeve të dukshme, përbën vlerësim favorizues, jo profesional dhe në kundërshtim me parimin e vlerësimit objektiv të ofertave.

Është edhe më e papranueshme që GOE ynë është eliminuar me arsyetimin se certifikatat tona nuk dëshmojnë “kryerjen me sukses” të trajnimit, ndërsa certifikatat e OE-së së rekomanduar, të cilat paraqesin mospërputhje shumë më serioze dhe dyshime për autenticitet, janë pranuar pa verifikim. Ky është standard i dyfishtë i hapur dhe favorizim i drejtpërdrejtë i OE-së së rekomanduar.

Ne si GOE i eliminuar nuk kemi qëllim të dëmtojmë imazhin e asnjë operatori ekonomik apo personi fizik, mirëpo duke pasur parasysh mospërputhjet serioze të evidentuara, jemi të obliguar t'i ngrisim këto dyshime dhe të kërkojmë verifikimin e plotë të dokumenteve nga organet kompetente.

Për këtë arsye, kërkojmë nga AK që të mos i pranojë këto certifikata si dëshmi valide pa verifikim të drejtpërdrejtë nga organi/personi që pretendohet se i ka lëshuar ato. Po ashtu, kërkojmë që AK të kërkojë konfirmim zyrtar për secilën certifikatë, përfshirë kodin unik, datën e lëshimit, pjesëmarrësin, nënshkruesit dhe formatin zyrtar të certifikatës.

Në rast se AK nuk e shqyrton këtë pretendim në mënyrë serioze dhe nuk e verifikon autenticitetin e certifikatave të dorëzuara nga OE i rekomanduar, ne do të ndjekim të gjitha rrugët ligjore përmes organeve përkatëse për të verifikuar vërtetësinë e këtyre dokumenteve. Nëse dyshimet tona rezultojnë të bazuara, do të kërkojmë ndërmarrjen e të gjitha masave ligjore ndaj OE-së së rekomanduar dhe ndaj çdo personi përgjegjës për dorëzimin, pranimin ose mosverifikimin e këtyre dokumenteve në këtë procedurë të prokurimit.

Prandaj, kërkojmë që ky pretendim të aprovohet si i bazuar dhe të konstatohet se certifikatat DDD të dorëzuara nga OE i rekomanduar nuk mund të pranohen si dëshmi valide pa verifikim të plotë zyrtar. Rrjedhimisht, oferta e OE-së së rekomanduar nuk është dashur të vlerësohet si e përgjegjshme mbi bazën e dokumenteve të tilla të dyshimta.

Plotësim / kundërpërgjigje lidhur me certifikatat DDD të OE-së së rekomanduar

Lidhur me këtë pretendim, sqarojmë se pas evidentimit të mospërputhjeve serioze në certifikatat DDD të dorëzuara nga OE i rekomanduar, GOE ynë ka ndërmarrë hapa konkretë për verifikimin e tyre dhe ka kontaktuar organizatën/personin kompetent që pretendohet se i ka lëshuar këto certifikata.

Nga përgjigja e pranuar rezulton se certifikatat në fjalë janë konfirmuar si reale/autentike, mirëpo të njëjtat janë të skaduara. Ky fakt është edhe më i rëndësishëm për këtë procedurë, sepse edhe nëse certifikatat janë reale, ato nuk mund të pranohen si dëshmi valide nëse në momentin e dorëzimit të ofertës nuk kanë qenë të vlefshme.

Si dëshmi për këtë pretendim, bashkëngjitur paraqesim komunikimin/përgjigjen e pranuar nga organizata/personi kompetent, ku konfirmohet se certifikatat janë reale, por të skaduara. [Dëshmia: Përgjigja zyrtare për verifikimin e certifikatave DDD të OE-së së rekomanduar]

RE: New message from Royalcert Web Contact Form

DERYA YILDIZ <derya.yildiz@royalcert.com>
Cc: Florian Syta <florian.syta2@gmail.com>

18 June 2020 at 09:11

Dear Florian Syta,

We received reply below from our Albania agent:

- 1 Yes, these certificates are issued by RCA Shqip and match with our register data. There is no manipulation on the attached ones. This has been a training module we have had during 2019-2020 but it was not successful and this training module is closed from end of 2020. So, we don't offer this training module for many years.
- 2 **All these certificates have 5 years expiry date as they are already in expired status now.** This is written in the certificate in small letters and don't need interpretation. We can't make renovation of these trainings even if these clients will ask again for renovation because this training module is not offered anymore.

Thank you,



Kind Regards,

Derya Yıldız
Accreditation Manager

Phone: +1 (832) 277-8130
Mobile: +90 535 803 88 51
Web: www.royalcert.com
Email: Derya.Yildiz@royalcert.com
50 Hunt St Suite 210, Waterlooville, 02472, USA

Prandaj, AK, Komisioni i Vlerësimit dhe Drejtori i Prokurimit nuk kanë pasur bazë që t'i pranojnë këto certifikata si dëshmi valide për përmbushjen e kërkesës së Dosjes së Tenderit. Kërkesa e DT-së nuk përmbushet me certifikata të skaduara, sepse certifikata e skaduar nuk dëshmon vlefshmëri aktuale të trajnimit/certifikimit në momentin relevant të procedurës së prokurimit.

Është e papranueshme që GOE ynë të eliminohet mbi bazën e një interpretimi formal lidhur me certifikatat tona, ndërsa OE i rekomanduar të vlerësohet si i përgjegjshëm me certifikata që, sipas verifikimit të bërë, janë të skaduara. Ky është standard i dyfishtë i qartë dhe vlerësim favorizues ndaj OE-së së rekomanduar.

AK ka pasur detyrim që para se ta shpallë OE-në e rekomanduar të përgjegjshëm, të verifikojë vlefshmërinë e certifikatave të dorëzuara. Mosverifikimi i këtyre dokumenteve dhe pranimi i certifikatave të skaduara si dëshmi valide përbën vlerësim joprofesional, të pasaktë dhe në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe vlerësimit objektiv të ofertave.

Si dëshmi shtesë, bashkëngjitur paraqesim edhe pamjen/screenshot-in e njëjës prej certifikatave të dorëzuara nga OE i rekomanduar, ku shihet qartë periudha e validitetit të certifikatës. Nga kjo dëshmi vërtetohet se certifikata nuk ka qenë valide në momentin relevant të procedurës së prokurimit dhe, për këtë arsye, nuk ka mundur të pranohet si dëshmi e vlefshme për përmbushjen e kërkesës së DT-së.

[Dëshmia: Screenshot i certifikatës DDD ku shihet validiteti/skadimi i certifikatës]

Praktik - Certificado - Certifikatë - Сертификат - شهادة - 証明 - Πιστοποιητικό



Rr. Todor Keça, Nr. 2,
qj. Shk. n.2, Kallit,
Tirana, Albania

Kodi i Certifikatës : 01-250820
Nr. Amzës së kursantit : SAOS / 01
Nr. i Kursit : 01-2020
Data e Lëshimit : 26/08/2020



Çertifikatë

Certificate

për të vërtetuar se
this is to certify that

SAFET OSMANI
SAFET OSMANI

lindur me datë 28/03/1973 në Bukosh, Kosovë
born on date 28/03/1973 in Bukosh, Kosova
ka kryer me sukses këtë kurs:
has successfully completed this course:

"Aplikues në Fushën e Shërbimit DDD (Dezinfektim, Deratizim dhe Desinsektim), si dhe mbi PMP (Praktikat e Mira të Punës) dhe PMH (Praktikat e Mira të Higjienës)"
"Applicability of DDD Service – Disinfection, Deratization and Disinfection and on GMP – Good Manufacturing Practices and GHP – Good Hygiene Practices"

nga data 22/08/2020 deri me datë 25/08/2020
from date 22/08/2020 to date 25/08/2020



Crown Your Quality...

Ing. Teknolog Ushqimor
Eng. Food Technologist

Doktoreshë
Doctor

Përfaqësuesi Ligjor /
Legal Representative

This training course / certificate is conducted and issued in accordance with all regulations, requirements and License issued by local authority of Republic of Albania. It is in accordance with ISO/IEC 17024:2012 (General requirements for bodies operating certification of persons) and under monitoring of "RoyalCert International Registrars GmbH" based in Frankfurt, Germany. The original certificate is printed on a special paper, contains QR code, original logos and the fresh original stamp and signature from certification authority. The validity of this certificate is 5 years. To verify this certificate contact: "RoyalCert Albania" (0035740) 44525190; Email: royalcertalbania@gmail.com; www.royalcert.com

23/06/2020Rev:002

Andaj, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë se arsyetimi i AK-së lidhur me certifikatat DDD të OE-së së rekomanduar është i pasaktë dhe i paqëndrueshëm. Rrjedhimisht, kërkojmë që ky pretendim të konsiderohet i bazuar dhe të vlerësohet se OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar me certifikata valide përmbushjen e kërkesës së DT-së për stafin e trajnuar/certifikuar për shërbime DDD.

Pretendimi Nr.6:

Shkelje e nenit 38.6 të Rregullores Nr. 001/2022 për shkak të caktimit të afatit 3-ditor për sqarim të tenderit

Përveç pretendimeve të lartcekura, GOE ynë konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, përkatësisht me nenin 38.6, lidhur me afatin e caktuar për sqarimin/plotësimin e dokumentacionit.

38.6 Autoriteti Kontraktues do të caktoj afat kohor jo më pak se pesë (5) ditë për Operatorët Ekonomik për sqarim të tenderit të tyre.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues, përmes formularit B47 “Kërkesë për sqarim të tenderit”, te datës 05.06.2026 ka kërkuar nga GOE ynë që sqarimet/dokumentet të dorëzohen brenda afatit 3-ditor. Mirëpo, neni 38.6 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik përcakton qartë se Autoriteti Kontraktues duhet të caktojë afat kohor jo më pak se pesë (5) ditë për Operatorët Ekonomik për sqarim të tenderit të tyre.

Deshmi nga B47 KERKESE PER SQARIM TE DT.pdf:

Nëse brenda afatit 3-ditor nuk dorëzohen sqarimet/dokumentet e kërkuara, ose nëse ato nuk plotësojnë kriteret e DT/NJK, oferta e GOE do të konsiderohet administrativisht e papërgjegjshme dhe do të eliminohet sipas nenit 72.4 LPP.

Pra, afati i caktuar nga AK prej vetëm 3 ditësh nuk është në përputhje me afatin minimal të paraparë me Rregulloren Nr. 001/2022. Ky veprim ka kufizuar padrejtësisht kohën në dispozicion të GOE-së tonë për përgatitjen e sqarimeve dhe dokumentacionit përkatës, duke cenuar parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe vlerësimit objektiv.

Edhe pse GOE ynë, me qëllim të bashkëpunimit korrekt dhe për të mos penguar procesin e vlerësimit, ka dorëzuar sqarimet brenda afatit të caktuar nga AK, kjo nuk e bën të ligjshëm afatin e vendosur nga Autoriteti Kontraktues. Respektimi nga ana jonë i një afati të shkurtër nuk e shëron shkeljen procedurale të AK-së, kur vetë rregullorja parasheh afat minimal prej jo më pak se pesë (5) ditësh.

Për këtë arsye, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 38.6 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke caktuar afat më të shkurtër se afati minimal i lejuar për sqarim të tenderit. Ky fakt duhet të merret parasysh si shkelje procedurale shtesë dhe si element që dëshmon se vlerësimi i ofertës sonë nuk është zhvilluar në mënyrë të drejtë, objektive dhe në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

PËRFUNDIM

Duke u bazuar në të gjitha pretendimet, faktet, dëshmitë dhe argumentet e paraqitura në këtë ankesë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, Rregullores për Prokurimin Publik dhe kërkesat e publikuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë.

Nga të gjitha pretendimet e paraqitura rezultojnë qartë se AK, Komisioni i Vlerësimit dhe Drejtori i Prokurimit kanë aplikuar standard të dyfishtë në vlerësim: ndaj GOE-së tonë janë aplikuar interpretime të ngushta, formale dhe eliminuese, ndërsa ndaj OE-së së rekomanduar për kontratë janë pranuar dokumente të paplota, të pasakta, të palexueshme, të paverifikueshme, të skaduar dhe dokumente që nuk përmbushin kërkesat materiale të Dosjes së Tenderit.

Në veçanti, kërkojmë nga OSHP që t'i konsiderojë si të bazuara këto pretendime:

Pretendimi nr. 1 – lidhur me interpretimin e gabuar të AK-së për ISO 9001:2015 dhe lejen/autorizimin për importimin e produkteve biocide, ku GOE ynë ka përmbushur kërkesat e publikuara në Dosjen e Tenderit si grup, ndërsa AK ka aplikuar kriter të papublikuar paraprakisht.

Pretendimi nr. 2 – lidhur me eliminimin e padrejtë të GOE-së tonë për Menaxherin e Kontratës dhe stafin teknik të trajnuar/certifikuar për shërbime DDD, ku dokumentet e dorëzuara nga ne dëshmojnë në përmbajtje përmbushjen e plotë të kërkesave të DT-së.

Pretendimi nr. 3.1 – lidhur me listën e kontratave/referencave të OE-së së rekomanduar, ku është dëshmuar se vlera e deklaruar prej 85,344.19 € nuk mbështetet në mënyrë të qartë, të saktë dhe të verifikueshme me referenca valide për kontrata/projekte të natyrës së ngjashme në lëmin e DDD-së.

Pretendimi nr. 3.2 – lidhur me kontratat e OE-së së rekomanduar të cilat janë paraqitur në listë, por janë jashtë periudhës 3-vjeçare të kërkuar në Dosjen e Tenderit, duke filluar nga koha e publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Pretendimi nr. 3.3 – lidhur me kontratën nr. 1 – KRU “Prishtina”, ku OE i rekomanduar ka deklaruar periudhë dhe vlerë deri më 10.08.2024 në shumën 5,760.00 €, ndërsa referenca e dorëzuar është e vitit 2022 dhe dëshmon vetëm vlerën 2,880.00 €.

Pretendimi nr. 3.4 – lidhur me kontratën nr. 6 – Kuvendi i Kosovës, ku OE i rekomanduar ka deklaruar në listë periudhë deri më 04.08.2023, ndërsa referenca zyrtare dëshmon se kontrata ka përfunduar më 04.08.2022.

Pretendimi nr. 3.5 – lidhur me kontratën nr. 9 – Administrata Tatimore e Kosovës, ku OE i rekomanduar ka deklaruar kontratë deri më 26.07.2023 në vlerë 22,143.96 €, ndërsa referenca dëshmon se shërbimet janë kryer në periudhën 16.03.2020 – 13.07.2020, jashtë periudhës së pranueshme.

Pretendimi nr. 3.6 – lidhur me kontratën nr. 10 – AVU, ku kontrata për “Identifikimin dhe regjistrimin e qenve me pronar” nuk është kontratë e natyrës së ngjashme në lëmin e DDD-së dhe nuk mund të llogaritet për përmbushjen e kriterit të kërkuar në DT.

Pretendimi nr. 3.7 – lidhur me kontratën nr. 11 – Gjykata Kushtetuese, ku kontrata ka të bëjë kryesisht me marrjen në shfrytëzim të pajisjeve/sensorëve për dezinfektim të duarve dhe jo me shërbime të natyrës së plotë DDD, ndërsa edhe vlera e deklaruar në listë nuk përputhet me vlerën e dëshmuar në referencë.

Pretendimi nr. 3.8 – lidhur me përfundimin se kontratat nr. 1, nr. 6, nr. 9, nr. 10 dhe nr. 11 përmbajnë mospërputhje materiale në periudhë, vlerë dhe natyrë të shërbimeve, andaj OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar përmbushjen e kriterit për kontrata/projekte të natyrës së ngjashme në lëmin e DDD-së, në vlerë së paku 40,000.00 €.

Pretendimi nr. 4.1 – lidhur me dyshimin serioz për përshtatje të specifikimeve teknike të pajisjeve në favor të OE-së së rekomanduar, për shkak të përputhjes pothuajse identike ndërmjet emërtimeve të pajisjeve në faturën nr. 32/2020 dhe emërtimeve të përdorura nga AK në Aneksin 8 të Dosjes së Tenderit.

Pretendimi nr. 4.2 – lidhur me mospërmbushjen e kërkesave për pajisjet dhe mekanizimin e obligueshëm, ku OE i rekomanduar ka deklaruar pajisje në katalog/listë, por nuk ka dorëzuar dëshmi të plota, të sakta dhe të verifikueshme për pronësinë apo posedimin e tyre.

Pretendimi nr. 4.3 – lidhur me DUD-in doganor të paplotë të dorëzuar nga OE i rekomanduar, ku mungon faqja kryesore me të dhënat esenciale si importuesi, deklaruesi, numri i deklaratës doganore dhe të dhënat identifikuese të subjektit.

Pretendimi nr. 4.4 – lidhur me faturën e EU1 SERVIS nr. 18/2020 për “Gjenerator motorik Ultra Low Volume (ULV)” me çmim 132.00 € për copë, çmim i cili është joreal, i pabesueshëm dhe shumëfish më i ulët se vlera reale e një pajisjeje profesionale ULV.

Pretendimi nr. 4.5 – lidhur me mospërmbushjen e kërkesës së DT-së për minimum 2 automjete “Pikap”, ku OE i rekomanduar ka dorëzuar dëshmi për automjete të përshkruara si “Furgon me 4 dyer” dhe jo si “Pikap”, siç është kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit.

Pretendimi nr. 5.1 – lidhur me diplomën e palexueshme të dorëzuar nga OE i rekomanduar për personin e propozuar si Epidemiolog/Veterinar/Mjek Veterinar, ku AK ka pranuar si valide një dokument që nuk mund të verifikohet qartë.

Pretendimi nr. 5.2 – lidhur me certifikatat DDD të OE-së së rekomanduar, ku pas verifikimit të bërë nga GOE ynë rezulton se certifikatat janë reale, mirëpo të skaduara, dhe si të tilla nuk mund të pranohen si dëshmi valide për përmbushjen e kërkesave të DT-së.

Pretendimi Nr.6 - lidhur me caktimin e afatit 3-ditor nga AK për sqarimin/plotësimin e dokumentacionit përmes formularit B47, afat i cili nuk është në përputhje me nenin 38.6 të Rregullores Nr. 001/2022, pasi kjo dispozitë kërkon që afati për sqarim të tenderit të jetë jo më pak se pesë (5) ditë.

Nga të gjitha këto fakte rezulton se OE i rekomanduar për kontratë, S.V. “Veterina”, nuk i ka përmbushur kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe nuk është dashur të vlerësohet si operator ekonomik i përgjegjshëm. Përkundër kësaj, AK ka anashkaluar mospërputhjet dhe mangësitë e dokumentacionit të tij, duke e rekomanduar për kontratë, ndërsa ka eliminuar GOE-në tonë mbi bazën e interpretimeve formale dhe selektive.

Ky veprim i AK-së ka cenuar rëndë parimet themelore të prokurimit publik, përfshirë trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, transparencën, konkurrencën e ndershme, vlerësimin objektiv dhe përdorimin efikas të parasë publike. Në këtë procedurë, AK nuk ka siguruar vlerësim të drejtë dhe të paanshëm, por ka krijuar efekt të drejtpërdrejtë favorizues ndaj OE-së së rekomanduar dhe diskriminues ndaj GOE-së tonë.

Andaj, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:

Ta aprovojë këtë ankesë si plotësisht të bazuar;

- T'i konsiderojë të bazuara pretendimet nr. 1, nr. 2, nr. 3.1, nr. 3.2, nr. 3.3, nr. 3.4, nr. 3.5, nr. 3.6, nr. 3.7, nr. 3.8, nr. 4.1, nr. 4.2, nr. 4.3, nr. 4.4, nr. 4.5, nr. 5.1, nr. 5.2 dhe nr.6
- Ta anulojë Vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim;
- Ta anulojë Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për rekomandimin e OE-së S.V. "Veterina" për kontratë;
- Të konstatojë se OE i rekomanduar nuk ka përmbushur kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe nuk është dashur të vlerësohet si i përgjegjshëm;
- Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që lëndën ta kthejë në rivlerësim të plotë, objektiv dhe të ligjshëm;
- Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që gjatë rivlerësimit ta eliminojë OE-në S.V. "Veterina" si të papërgjegjshëm, për shkak të mospërmbushjes së kërkesave të DT-së;
- Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që oferta e GOE-së tonë të rivlerësohet në mënyrë të drejtë, objektive dhe përmbajtësore, pa kritere të papublikuara, pa interpretime të zgjeruara dhe pa standarde të dyfishta;

Gjithashtu, duke marrë parasysh mënyrën se si është zhvilluar kjo procedurë deri më tani, favorizimet e evidentuara, trajtimin e pabarabartë, përgjigjet e përgjithshme të AK-së dhe mosshqyrtimin përmbajtësor të pretendimeve tona, kërkojmë nga OSHP që kjo procedurë të mbikëqyret me kujdes deri në përfundimin e saj, përfshirë fazën e rivlerësimit, rekomandimit për kontratë dhe deri në nënshkrimin eventual të kontratës.

Kjo kërkesë bëhet me qëllim që të parandalohet vazhdimi i vlerësimit të njëanshëm, favorizues dhe diskriminues, si dhe që kjo procedurë e prokurimit të zhvillohet në përputhje të plotë me parimet e ligjshmërisë, transparencës, trajtimit të barabartë, konkurrencës së ndershme dhe mbrojtjes së interesit publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Eliminim i pabazuar i ofertës.

Humbje e mundësisë për kontratë.

Trajtim i pabarabartë në vlerësim.

Cënim i konkurrencës së ndershme.

Dëm ekonomik ndaj GOE-së.

Shpenzime për përgatitje të ofertës që kapin vlerën prej 500 euro.

Shpenzime për përgatitjen e Ankesës në OSHP që kapin vlerën prej 1000 Euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*